

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6032
E martë, 9 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Stoltenbergu bën thirrje
për unitet të NATO-s

FAQE 2



PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, TË HËNËN KA MBAJTUR
KONFERENCË PËR MEDIA | FAQE 4-5

THAÇI: KOSOVA ËSHTË GATI PËR DIALOGUN ME SERBINË



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar të hënën se Kosova nuk ka çka të hezitojë në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës janë të gatshme që të lëvizin sa më

shpejt në këtë drejtim në mënyrë që vendi të anëtarësohet në BE e në NATO. Në një konferencë për media, shefi i shtetit ka vlerësuar se spektri politik duhet të jetë i bashkuar në këtë proces, duke

shprehur optimizëm se marrëveshja historike mund të arrihet gjatë këtij viti. Gatishmërinë për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi e kanë shprehur edhe liderët e tjera institucionalë të vendit

MOSRESPEKTI I MASAVE MBROJTËSE RRIT NUMRIN E TË INFETUARVE ME COVID-19 NË KOSOVË

MUND TË RIKTHEHEN MASAT RIGOROZE KUNDËR COVID-19.



Mikrobiologu Lul Raka ka thënë se nëse rritja e numrit të rasteve të reja me Covid-19 shkon paralelisht me numrin e madh të rasteve që kërkojnë kujdes intensiv dhe shtrirje në klinikë, atëherë mbyllja e sëri-ishme e vendit është opsjon real.

Edhe drejtori i Institutit të Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani, ka thënë se nëse Instituti sheh se qytetarët nuk po i përfillin rekomandimet, do të ndërmarrin masa rigorozë deri në kufizimin e lëvizjes apo qarkullimit

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

LAVDIA U TAKON ATYRE
QË FLIJOHEN PËR VIZIONE
TË MËDHA F. 7

Bedri
ISLAMI



AKTUALE

KUVENDI KËTË TË ENJTE
DO TË SHQYRTOJË NJË VARG
PROJEKTIGJESH F. 8

KURTI VIZITOI DISA PREJ
PIKAVE KU PO NËNSHKRUHET
PETICIONI PËR ZGJEDHJE TË
REJA F. 5

FILLON MËSIMI PLOTËSUES
PËR TESTIN E ARRITSHMËRISË
PËR NXËNËSIT E KLASAVE TË
NËNTA F. 6

EKONOMI

BIEN ÇMIMET E PRODHIMIT
NË KOSOVË F. 9

KEK-u SHTON MASAT
MBROJTËSE KUNDËR
PËRHAPJES SË PANDEMISË F. 8

SPORT



FHK-ja, THIRRJE
HENDBOLLISTËVE
NË DIASPORË: KOSOVA PO
JU PRET F. 18

Stoltenbergu bën thirrje për unitet të NATO-s

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se aleanca

30-anëtarëshe duhet të "qëndrojë ushtarakisht e fortë, të jetë më e bashkuar politikisht dhe të ketë qasje më të gjërë në nivel global", në mënyrë që të vazhdojë t'i "mbrojë demokracitë tonë" në një "botë me më shumë gara".

Në një fjalim, duke prezantuar vizionin e NATO-s deri më 2030, Stoltenberg u ka bërë thirrje aleatëve që të vazhdojnë të investojnë në forcat e tyre të armatosura, ta përdorin aleancën si forum për diskutim dhe ku është e nevojshme të intervenohet në çështjet që prekin sigurinë e përbashkët si dhe të punojnë më afér me partnerë si Australia, Japonia, Zelanda e Re, Koreja Jugore në mënyrë që të mbrohen "rregullat globale dhe institucionet që na kanë mbajtur të sigurt për dekada".

"Qëndroni për një botë të ndërtuar në liri dhe demokraci. Jo në ngacmim dhe shtrëngim", ka thënë ai gjatë një ngjarjeje të mbajtur online me Këshillin

Atlantik dhe Fondin Marshall të Shteteve të Bashkuara.

Stoltenbergu ka thënë se Rusia "vazhdon të mos zvogëlojë aktivitetet ushtarake", grapi militant, Shteti Islamik dhe grupet e tjera janë duke u motivuar, derisa aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë promovojnë "dezinformata dhe propagandë".

Ai ka thënë se rritja e Kinës "përbën zhvendosje të ekuilibrit global të pushtetit, duke ngritur garën për mbizotërim ekonomik e teknologjik".

Fjalimi i Stoltenbergut ka ardhur teksta aleatët e Shteteve të Bashkuara në Evropë kanë shprehur zhgënjim pas raportimeve se ekziston plan për tërheqjen e trupave amerikane nga Germania.

I pyetur rrëth këtyre planeve, ai ka refuzuar të komentojë drejtëpërdrejt "për spekulimet e medias", mirëpo ka mbrojtur përkushtimin e Shteteve të Bashkuara në Evropë, duke thënë: "Në vitet e fundit ne kemi parë sërisht një rritje të prezencës amerikane në Evropë. Dhe kjo



nuk ka të bëjë vetëm me Gjermaninë. Ne kemi parë, shembull, një brigadë të re amerikane të angazhuar në Evropë, ne kemi parë prezencë rotative, ne kemi parë ShBA-në,

në role udhëheqëse në grupin e betejës së NATO-s në Poloni", ka thënë Stoltenbergu.

Largimi potencial i trupave amerikane nga Gjermania është raportuar fillimisht nga The Wall

Street Journal dhe Der Spiegel një javë më parë.

Qeveria gjermane ka thënë se ende nuk ka pranuar ndonjë konfirmim nga Uashingtoni lidhur me këto pretendime.



Cakaj: Mbretëria e Bashkuar vlerëson lart ujdinë ndërpartiake për reformën zgjedhore

TIRANË, 8 QERSHOR (ER) - Ministri për Evropën dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka zhvilluar të hënën një bisedë me ministren për Fqinjësinë Evropiane dhe të Mbretërisë së Bashkuar, Wendy Morton. "Biseduam për bashkëpunimin tonë të shkëlqyer në kuadër të OSBE-së. Po ashtu, ministren e informova për synimin e Shqipërisë për të shërbyer si anëtar jo i përhershëm i

Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 2022-2023", ka bërë me dije Cakaj.

Ai ka theksuar se Mbretëria e Bashkuar vlerëson lart ujdinë ndërpartiake për reformën zgjedhore dhe mbështet fuqishëm rrugën evropiane të Shqipërisë. "Në fund u pajtum am t'i vazhdojmë bisedimet për lidhjen e disa marrëveshjeve për ta thelluar marrëdhëni dypalëshe mes dy vendeve tona", ka thënë Cakaj.

Shqipëria u godit nga një tërmet 4.5 shkallë

TIRANË, 8 QERSHOR - Lëkundje të forta tërmeti janë ndier të hënën rreth orës 17:20 në Tiranë, Durrës dhe në zonat përreth këtyre dy qyteteve të Shqipërisë. Sipas Qendrës Evropiane të Sismologjisë, tërmeti ka qenë me magnitudë 4.5 i shkallës Rihter, ndërsa thellësia ishte vetëm

dy kilometra. Epiqendra e tërmetit ka qenë 17 kilometra në veriperëndim të Shijakut dhe 38 kilometra në veriperëndim të Tiranës. Për momentin nuk është raportuar përdëme në njerëz apo në ndërtesa. Shqipëria vazhdon të përbal-

let me pasojat e një tërmetit të fuqishëm me magnitudë 6.4 shkallësh të Rihterit, që goditi këtë vend në muajin nëntor të vitit 2019, duke lënë të vdekur 51 persona dhe qindra të tjerë të plagosur. Thumana dhe Durrësi pësuan më së shumti nga dridhjet e fuqishme të

tërmetit. Në Konferencën e Donatorëve që është mbajtur në Bruksel në muajin shkurt të 2020-s, Shqipëria ka mbledhur 1.15 miliard dollarë ndihmë për t'u rikuperuar nga pasojat e tërmetit të



nëntorit, i cili, po ashtu, ka lënë mijëra persona të pas-trehë.

Mosrespektimi i masave mbrojtëse rrit numrin e të infektuarve me Covid-19 në Kosovë

Mund të rikthehen masat rigorozë kundër Covid-19

Mikrobiologu Lul Raka ka thënë se nëse rritja e numrit të rasteve të reja me Covid-19 shkon paralelisht me numrin e madh të rasteve që kërkojnë kujdes intensiv dhe shtrirje në klinikë, atëherë mbyllja e sërishtme e vendit është opsim real. Edhe drejtori i Institutit të Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani, ka thënë se nëse Institutit sheh se qytetarët nuk po i përfillin rekomandimet, do të ndërmarrin masa rigorozë deri në kufizimin e lëvizjes apo qarkullimit



EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Mosrespektimi i masave mbrojtëse ka rezultuar me rritje të numrit të të infektuarve me Covid-19 në Kosovë. Në Kosovë vetëm gjatë ditës së diel janë regjistruar 40 raste të reja me Covid-19. Nisur nga rritja e numrit të rasteve me koronavirus, autoritetet shëndetësore u kanë bërë thirrje qytetarëve për respektim të masave mbrojtëse: si ruajtja e distancës fizike, mbajtja e maskave si dhe higjiena personale.

Gjatë një vizite në pikën kufitare në Vërmicë, që lidh Kosovën me Shqipërinë, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka kërkuar nga qytetarët që të janë më të kujdeshëm gjatë lëvizjes së

tyre. Drejtori i Institutit të Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani, tha se nëse Institutit sheh se qytetarët nuk po i përfillin rekomandimet, do të ndërmarrin masa rigorozë deri në kufizimin e lëvizjes apo qarkullimit. Ndërkaq, mikrobiologu Lul Raka ka thënë se nëse rritja e numrit të rasteve të reja me Covid-19 shkon paralelisht me numrin e madh të rasteve që kërkojnë kujdes intensiv dhe shtrirje në klinikë, atëherë mbyllja e sërishtme e vendit është opsim real. Në Kosovë vetëm gjatë ditës së diel janë regjistruar 40 raste të reja me Covid-19. "Përveç numrit të rasteve, faktor vendimtar mund të jetë struktura klinike e këtyre rasteve të reja. Nëse ato janë raste të lehta të kontaktit familjar (disa edhe

asimptomatike), të cilat nuk kanë nevojë për hospitalizim, atëherë ato janë të menaxhuar për sistemin shëndetësor dhe nuk ka nevojë për mbyllje të sërishtme. Nëse rritja e numrit të rasteve të reja shkon paralelisht me numrën të madh të rasteve që kërkojnë hospitalizim dhe kujdes intensiv, atëherë mbyllja e sërishtme është opsim real", ka shkruar Raka në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka kërkuar nga qytetarët e Kosovës që t'i

respektojnë masat mbrojtëse në mënyrë që virusi të mbahet nën kontroll. Në Klinikën Infektive të QKUK-së të hënën janë të shtrirë 20 pacientë me Covid-19. Sipas një njoftimi të QKUK-së, gjendja e pacientëve të sëmurë me Covid-19 është kjo: 14 raste janë në gjendje stabile, pesë raste në gjendje të rëndë janë duke u trajtuar në repart me oksigenoterapi dhe përkujdesje intensive.

Ndërkaq në repartin e Mjekimit Intensiv është duke u trajtuar një rast në gjendje të rëndë me oksigenoterapi dhe përkujdesje intensive. Rastet e para me Covid-19 në Kosovë u regjistruan më 13 mars. Sipas të dhënave të fundit, në Kosovë, që prej shfaqjes së rasteve të para me Covid-19 më 13 mars, janë regjistruar 1 234 raste dhe 31 pacientë kanë vdekur dhe 890 pacientë janë shëruar.

Norvegjia pritet ta ndihmojë Kosovën me respiratorë

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grendahl, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin midis dy shteteve në përgjigjen ndaj pandemisë Covid-19.

Ministri Zemaj e ka njoftuar ambasadorin Grandahl për masat e qeverisë në menaxhimin e kësaj faze të pandemisë dhe ka shprehur falënderimin e tij për kontributin që populli i Norvegjisë i ka dhënë Kosovës për ballafaqim me Covid-19. Ai e ka informuar ambasadorin Grandahl për aktivitetet e ndërmarrë në tërë territorin e Kosovës me qëllim të tejkalimit të situatës rreth pandemisë.

Ndërkaq ambasadori Grandahl e ka njoftuar ministrin Zemaj se në kuadër të ndihmave që Norvegjia i ka dhënë Kosovës në ballafaqim me pandeminë, gjatë kësaj jave pritet që në Kosovë të arrijnë një numër respiratorësh me të cilët ky shtet do ta ndihmojë Kosovën përfuqizimin e kapaciteteve kundër Covid-19.

Bashkëbiseduesit në këtë takim kanë shprehur përkushtimin që ta vazhdojnë bashkëpunimin, ndërkohë që qytetarëve u kanë bërë thirrje që t'i zbatojnë masat e ndërmarrë, në veçanti bartjen e maskave, ruajtjen e distancës fizike dhe mbajtjen e higjienës personale e kolektive si mënyrë përfshirë parandaluar përhapjen e infeksionit.



PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, TË HËNËN KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

THAÇI: KOSOVA ËSHTË GATI



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, ka deklaruar të hënën se Kosova nuk ka çfarë të hezitojë në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës janë të gatshme që të lëvizin sa më shpejt në këtë drejtim në mënyrë që vendi të anëtarësohet në BE e në NATO. Në një konferencë për media, shefi i shtetit ka vlerësuar se spektri politik duhet të jetë i bashkuar në këtë proces, duke shprehur optimizëm se marrëveshja historike mund të arrihet gjatë këtij viti. Gatishtërinë për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi e kanë shprehur edhe liderët e tjerë institucionalë të vendit

**EPOKA
ERE**

Muhamed KOÇI

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, ka bërë me dije se Kosova është gati që të rikthehet në procesin e dialogut me Serbinë. Në një konferencë për media, presidenti ka deklaruar të hënën se Kosova nuk ka çfarë të hezitojë në këtë drejtim, duke shtuar se është një rrugëtim i sigurt, i cili do të përmbyllët sipas vullnetit të qytetarëve të vendit. "E para si president shpreh mirënjohjen për heqjen e çfarëdo preteksti që Serbia e ka shfrytëzuar për t'i ikur

dialogut. Kosova e ka të qartë se çfarë kërkon në dialog. Mbi të gjitha, Kosova në këtë proces është bashkë me ShBA-në dhe të gjithë aleatët e tjerë", ka thënë ai. Shefi i shtetit ka vlerësuar se spektri politik dhe institucionet e Kosovës duhet të jenë të bashkuara në këtë proces. Sipas tij, në procesin e dialogut me Serbinë duhet lëvizur sa më shpejt. "Duhet të lëvizim sa më shpejt në këtë drejtim që të jemi pjesë e BE-së dhe e NATO-s. Pushtetet janë të ndara, por përballet Serbisë duhet të jemi të gjithë të bashkuar. Unë besoj se do të ketë hapa konkretë në këtë drejtim. Ne kemi pasur

disa kauza të rrejshme që e kanë vonuar shtetin e Kosovës", është shprehu Thaci. I pyetur se a mund të arrihet marrëveshja me Serbinë brenda vitit, presidenti Thaci ka thënë se ka besim që gjérat do të lëvizin në drejtim të duhur. "Kam besim të plotë në energjinë dhe dinamikën e ShBA-së dhe presidentin Donald Trump dhe ambasadorin Grenell. Ne duam dhe destinacioni ynë është i qartë, që të jemi pjesë e familjes evropiane, por ne jemi të vetëdijshëm se punën e shpejtë në këtë proces e ka udhëhequr ShBA-ja", ka deklaruar Thaci.

Ai ka shtuar se Kosova do të punojë në zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura në fillim të këtij viti, si marrëveshja për linjën ajrore Prishtinë - Beograd dhe autostradën që lidh Kosovën me Serbinë. "Dëshiroj, gjithashu, të potencoj se vendimet e qeverisë u pasuan me reagimin pozitiv të ShBA-së. Menjëherë u zhbllokuat fondet e MCC-së. Bursat që u patën ndalur tani do t'i marrin përsëri. Vendimet e fundit që sollën këto të arritura, dëshmuan se nuk duhet të vonohemi, se duhet të marrim vendime të rëndësishme, por edhe dëshmuan se kauzat si demarkacioni, taksa ishin populiste dhe i humbën kohë Kosovës, u shkaktuan dëme institucioneve të vendit dhe imazhit tonë", ka thënë ai.


Mbështetje dialogut i ka dhënë edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti. Ai ka thënë se kryeministri i vendit do ta udhëheqë dialogun me Serbinë pasi kështu e thotë Kushtetuta e Kosovës. Në mbledhjen që qeveria e ka

hequr vendimin për reciprocitetin me Serbinë, Hoti ka thënë se heqja e kësaj mase nënkuption largimin e pengesave për vazhdimin e dialogut. Ai ka thënë se ende nuk është vendosur ndonjë afat se deri kur ka kohë Serbia ta ndalë fushatën ndërkombëtare kundër Kosovës.

Kuvendi do ta mbikëqyrë dialogun

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se Kuvendi do ta mbikëqyrë retepë procesin e dialogut me Serbinë. Pas takimit me shefen e Zyrës së BE-së, Nataliya Apostolova, ajo ka thënë se Kosova nuk do të lejojë asnjë dialog në të cilin diskutohet tërësia territoriale e Kosovës. "Procesi i dialogut me Serbinë duhet të jetë i kujdeshshëm. Ne nuk pranojmë asnjë version dialogu me të cilin negociohet tërësia territoriale e Kosovës. Kuvendi do të ketë rol të retepë mbikëqyrës dhe do të

PËR DIALOGUN ME SERBINË



insistojmë maksimalisht në rritjen e transparencës për procesin e dialogut. Gjithashtu, do të kërkojmë raportim në Kuvend për se cilën fazë të negociatave", ka thënë Osmani.

Më herët, ajo ka kërkuar që presidenti i vendit të sqarojë para publikut nese ka hequr dorë nga ideja për shkëmbim të territoreve në këtë proces.

"Jo për dialog të tipit të Thaçit që involvon negociata sekrete me presidentin e Serbisë dhe ka rezultuar me hapjen e temave të rrezikshme. Në vend se të dalë të marrë kompetenca

të qeverisë, ai do të duhet të dalë e të deklarojë: A u garanton të gjithë qytetarëve se nuk do të vë në asnjë tavolinë çështjen e territorit të Republikës së Kosovës dhe të sqarohet nese ka hequr dorë nga ideja e tij dhe Vuçiqit për korrigim të kufirit", ka deklaruar Osmani.

Ajo ka vlerësuar se këto ide janë në kundërshtim me idenë e popullit të Kosovës.

Përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, planifikon që së shpejtë të marrë rrugë drejt

Prishtinës dhe Beogradit. "Lajçaku planifikon të udhëtojë drejt Kosovës dhe Serbisë sapo të krijohen kushtet që lejojnë diskutimin e modalitetave përrikthim në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja me të gjitha palët", ka bërë me dije Zyra e Lajçakut për "Klan Kosovën". Kjo zyrë ka bërë me dije se nuk ka një datë të saktë se kur Lajçaku do t'i vizitojë Kosovën dhe Serbinë. "Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell dhe përfaqësuesi special, Miroslav Lajçak, po shohin bashkërisht bashkëpunim me qeverinë e re të drejtuar nga kryeministri

Gjermania dhe Franca mbështesin dialogut

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pasur një bisedë telefonike me Emmanuel Bonnen, këshilltarin diplomatik të presidentit të Francës, Emmanuel Macron. Zyra e kryeministrat ka njoftuar se Bonne ka thënë se Franca e mbështet dialogun mes Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Po ashtu, ka thënë se Franca mbështet përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për reformat demokratike, luftimin e korrupsionit dhe pasojave të pandemisë Covid-19. Gjatë ditës kryeministri ka

marrë një telegram urimi nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ku përmendet edhe dialogu me Serbinë. "Ju dhe qeveria juaj keni sfida të mëdha përpjekje, veçanërisht përbashkët me pandeminë Covid-19, reformat kushtetuese dhe dialogu me Serbinë për normalizim, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Qeveria federale mbetet e gatshme ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj dhe të punojë për t'i kuptuar vendet e Ballkanit Perëndimor", është thënë në telegramin e kancelares gjermane.

Avdullah Hoti drejt përparimit në marrëdhëni BE - Kosovë. Pandemia e koronavirusit dhe pasojat e saj do të janë sfidë e përbashkët. Ne duam ta shohim Kosovën përpjekje në rrugën evropiane. Një rinisje e shpejtë e dialogut Beograd – Prishtinë, e lehtësuar nga BE-ja, është kyçe për normalizimin

gjithëpërfshirës në marrëdhëni me Serbinë", ka thënë Zyra e Lajçakut.

Dialogu Kosovë - Serbi është ndërprerë qysh në fund të vitit 2018 për shkak të taksës 100 për qind që u kishte vënë Qeveria e atëhershme e Kosovës ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia.

Odalloviq: Dialogu mund të fillojë pas zgjedhjeve në Serbi

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, Velko Odaloviq, ka deklaruar se pas heqjes së masave të reciprocitetit nga Qeveria e Kosovës, janë krijuar kushtet përvazhdimin e dialogut në mes të Beogradit e Prishtinës. Ai ka thënë se dinamika e këtij procesi do të dihet pasi i deleguari special i Bashkimit Evropian, Miroslav Laçak, ta vizitojë Beogradin e Prishtinë. "Nuk e përjashtoj mundësinë

që ofensiva diplomatike të vazhdojë gjatë verës, por supozoj se fillimisht do të pritet të përfundojë procesi zgjedhor në Serbi. Jo pse ka ndonjë të papritur dhe të panjohur, kur është fjala përmëndatin e atij që i prin dialogut, presidentin Aleksandar Vuçiq, kjo nuk vihet në pyetje në asnjë rast. Kur Lajçak të vijë në Beograd e në Prishtinë do të dihet përdinamikën e këtij procesi", ka deklaruar Odaloviq.

Kurti vizitoi disa prej pikave ku po nënshkruhet peticioni për zgjedhje të reja

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vizituat të hënën disa prej pikave ku po nënshkruhet peticioni për zgjedhje të reja në Prishtinë. Së bashku me disa aktivistë, ai fillimisht ka vizituat pikën në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë, ku numri i nënshkruesve ka qenë i madh,

për të vazhduar në lagjen Tauk Bahçe, në të cilën ka takuar disa qytetarë që po e nënshkruan peticionin, më pas ka vizituat edhe lagjen Mati, te rrëthi i qytetit dhe sheshi qendror. "Nënshkrimi i peticionit po vazhdon nëpër të gjitha qytetet. Mbrëmë kaloi numrin 150 mijë dhe besojmë se këtë javë do ta kalojë numrin 200 mijë.

Qytetarët janë të bindur se e vetmja mënyrë për ta rikthyer një qeverisje legitime në vend është përmes zgjedhjeve të lira që duhet të organizohen sa më parë. Ditëve në vijim kryetari Kurti do t'i vizitojë edhe qytetet e tjera ku po nënshkruhet peticioni", është bërë me dije në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.



Kryeministri Hoti bisedoi në telefon me këshilltarin e Macronit

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pasur të hënën një bisedë telefonike me Emmanuel Bonne, këshilltar diplomatik i presidentit të Republikës së Francës, Emmanuel Macron, të cilin e ka falënderuar përmblështjen në të kaluarën

dhe gatishmërinë e Francës për ta ndihmuar Kosovën në rrugën e integrimeve euroatlantike. Me këtë rast, Bonee, duke e përgëzuar kryeministrin Hoti për detyrën e re, tha se Franca i mbështet përpjekjet e Qeverisës së Kosovës për reformat demokratike, luftimin e kor-

rupcionit dhe pasojave të pandemisë Covid-19. Duke i potencuar marrëdhëniet e shkëlqyeshme që ekzistojnë në mes dy vendeve tona, Emmanuel Bonne ka pohuar se Franca e mbështet dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga Bashkimi Evropian.



Fillon mësimi plotësues për testin e arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka kontaktuar të hënën të gjitha drejtori të komunale të arsimit dhe, sipas raportimeve, procesi i fillimit të përgatitjeve në shkolla për testin e arritshmërisë ka shkuar sipas kalendarit të përshtatur nga MASHTI përfundimin e vittit shkollor 2019/2020 në rrethana të pandemisë Covid-19.

Sipas raportimeve të DKA-ve, mësimi plotësues për nxënësit e klasave të nënta, i paraparë të fillojë të hënën me kalendarin e përshtatur, ka filluar në të gjitha komunat, përvèç në Komunën e Malishevës dhe atë Junikut, për arsy se nuk kanë pasur mundësi t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme në të gjitha shkollat dhe në këto komuna mësimi pritet të fillojë gjatë javës.

Paraprakisht, sipas deklarimeve të përgjegjësve të arsimit nëpër komuna, është bërë edhe dezinfektimi i objekteve shkollore dhe janë siguruar dezinfektues dhe maska në shkolla dhe po zbatohen rekomandimet e IKShP-së.

Mësimi plotësues për përgatitje për testin e arritshmërisë do të zgjasë deri më 19 qershori, ndërsa testi do të mbahet më 23 qershori.

Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ramë Likaj, bashkë me drejtoreshën e Arsimit në Prishtinë, Shpresa Shala, kanë



Sami Frashëri

vizituar të hënën Shkollën Filliore dhe të Mesme të Ulët "Faik Konica" në Prishtinë, për të parë nga afër rrjedhën e ditës së parë të mësimit plotësues për klasat e nënta, para mbajtjes së testit të arritshmërisë. Ministri Likaj, me këtë rast, ka takuar menaxhmentin e shkollës, mësimdhënësit dhe nxënësit, me të cilët ka biseduar përsfidalit e

organizimit të mësimit plotësues, ndërsa ka kërkuar nga ata të respektojnë Udhëzuesin e hartuar nga MASHTI në të cilin janë të përshkruara në detaje udhëzimet dhe masat të cilat duhet të ndërmerren për ta realizuar mësimin plotësues dhe testin e arritshmërisë. Ministri Likaj i ka lutur nxënësit, mësimdhënësit dhe gjithë stafin e kësaj shkolle dhe

të gjitha shkollave në Kosovë, që t'i respektojnë masat mbrojtëse të rekomanduara nga Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHP-ja, përfshirë ato të bartjes së maskave, higjenës dhe distancës sociale në të gjitha ambientet ku ndodhen dhe të sillen me përgjegjësi, pasi që çdo pakujdesi mund të ndikojë në rrezikun e përhapjes së infeksionit.

Po ashtu, ministri Likaj ka përgëzuar edhe menaxhmentin dëshimdhënësit e kësaj shkolle për ndërtimin e tunelit dezinfektues para objektit të shkollës si dhe për punimin e maskave mbrojtëse për nxënësit e tyre me kosto minimale, ndërsa ka theksuar se ky shembull duhet të ndiqet edhe nga institucionet e tjera shkollore.

Klinika e Neonatologjisë për tre muaj ofroi ndihmë mjekësore për 1 918 foshnja

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Klinika e Neonatologjisë gjatë tre muajve të fundit ka ofruar shërbime të nevojshme shëndetësore për të gjitha foshnjat,

përkundër situatës së krijuar me virusin Covid-19. Nga të dhënat e dala prej raportit të punës, në këtë klinikë janë trajtuar 1 918 foshnja me probleme të

natyrale të ndryshme. 72 prej tyre janë transferuar nga spitalet regionale, përfshirë edhe ato private për trajtim të mëtutjeshëm. Nga numri i

përgjithshëm, në Neonatologji janë pranuar 149 foshnja të lindura para kohe, kurse kujdesit intensiv i janë nënshtruar 223 foshnja.



Hoti, Apostolovës: Do të punojmë ngushtë me BE-në për ta përshpejtar procesin e integrimit

Kryeministri Avdullah Hoti ka takuar të hënën ndaras shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian, Nataliya Apostolova dhe ambasadorin e Italisë, Nicola Orlando, nga të cilët ka marrë urime për zgjedhjen në postin e kryeministrit të vendit. Hoti ka thënë se Qeveria e Kosovës do të punojë ngushtë me BE-në për ta përshpejtar procesin e integrimit të vendit tonë në familjen e vendeve demokratike evropiane

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në një takim shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova. Gjatë këtij takimi, kryeministri Hoti ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës do të punojë ngushtë me BE-në për ta përshpejtar procesin e integrimit të vendit tonë në familjen e vendeve demokratike evropiane. Kryeministri Hoti ka folur edhe

për priorititet aktuale të Qeverisë së Kosovës siç janë menaxhimi i pandemisë Covid-19 dhe rimëkëmbja ekonomike e vendit.

Hoti ka thënë se Kosova është jashtëzakonisht mirënjojëse për mbështetjen konkrete nga BE-ja në luftën kundër pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Me këtë rast, ai tha se Qeveria e Kosovës njëkohësisht do të punojë me tërë kapacitetin e saj për forcimin e rendit dhe ligjit, për thellimin e demokracisë, luftimin e korruptionit, zbutjen e papunësisë dhe zhvillimin e



tregut të lirë. Ndërsa ambasadorenja Apostolova, pasi e ka përgëzuar kryeministrin Hoti për detyrën e re, ka theksuar se Bashkimi Evropian do të vazhdojë t'i përkrahë institucionet e Kosovës për menaxhimin e pandemisë Covid-19 si dhe do t'i sigurojë Qeverisë së Kosovës mbështetje financiare për rimëkëmbjen ekonomike. Gjithashtu, ajo vuri theksin në funksionimin e shtetit ligjor dhe demokratik si kusht i rëndësishëm në procesin e afrit të Kosovës drejt BE-së. Po ashtu, kryeministri Hoti ka pritur të hënën në takim edhe

ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, Nicola Orlando. Gjatë këtij takimi Hoti e ka falënderuar ambasadoren Orlando për mbështetjen e përhershme të Italisë për vendin tonë si dhe ka pohuar vendosmërinë e Qeverisë së Kosovës për të punuar ngushtë me Italinë edhe në të ardhmen. Kryeministri Hoti e ka njoftuar ambasadoren Orlando për detyrën e re, ka pohuar se Italia do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në luftimin e pandemisë Covid-19 si dhe në përpjekjet e saj për t'i përmirësuar marrëdhëniet rajonale, mbështetjen e zhvillimit ekonomik, forcimin e sundimit të ligjit dhe luftën kundër korruptionit.



Ministri Selimi premton mbështetje për viktimat e dhunës në familje

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka vizituar të hënën Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) në Prishtinë, me ç'rast është takuar me drejtoreshën e QMGF-së, Zana Asllani, si dhe udhëheqësen e UN Women, Zyra në Kosovë, Vlora Tuzi-Nushi.

Ministri Selimi në vizitën e parë zyrtare është njoftuar për sfidat dhe mundësitet e bashkëpunimit me strehimoret e viktimate të dhunës në familje. "Kjo është vizita ime e parë zyrtare dhe jorastësishët e kemi zgjedhur këtë strehimore për ta dërguar mesazhin se dhuna në familje duhet të trajtohet seriozisht. Dhuna në familje është një shqetësim i yni, së cilës do t'i qasemi në mënyrë serioze", ka thënë ministri Selimi.

Pas përfundimit të takimit, ministri Selimi ka takuar edhe disa nga viktimat e dhunës në familje, që janë të strehuara në këtë qendër. "Pata rastin të takohem edhe me disa nga viktimat e dhunës që janë të strehuara këtu dhe mesazhi imi ishte: hapi i parë, më i madh dhe më i vështiri është ardhja e viktimate të dhunës në këtë qendër sepse kjo është një shkëputje e zinxhirët të dhunës", ka thënë ai.

Ministri Selimi ka pohuar se shumë shpejt do të adresohet edhe çështja e riintegrimit të viktimate të dhunës në familje. "Sfida më e madhe është riintegrimi i tyre. Besoj se shumë shpejt, në bazë të disa rekomandimeve që kemi bërë bashkë me Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, të fillojmë menjëherë që ta shikojmë



mundësinë e bashkëpunimit me sektorin privat", ka deklaruar ministri Selimi. I pari i Ministrisë së Drejtësisë falënderoi të gjithë ata të cilët janë angazhuar në çështjet që kanë të bëjnë me viktimat e

dhunës në familje, me theks të veçantë ish-zëvendësministrin Naim Qelaj, njëherësh edhe ish-Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje në Ministrinë e Drejtësisë. Ndërsa drejtoresha e QMGF-së,

Zana Asllani, falënderoi ministrin Selimi për mbështetje, duke shtuar se kjo vizitë tregon gatishmërinë dhe interesimin e institucioneve për t'i ndihmuar strehimoret e viktimate të dhunës në familje.

Mbyllen tri kopshte të fëmijëve në Prishtinë pas identifikimit të rasteve me Covid-19

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) -
Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se të hënën janë mbyllur tri kopshte të fëmijëve pas identifikimit të rasteve të infektuara me Covid-19. Sipas Ahmetit, dy fëmijë kanë rezultuar pozitivë, kurse në një njërin prej kopshteve është thënë se bashkëshorti i një edukatoreje është prekur, po ashtu, nga Covid-19. “Për shkak të kujdesit ne kemi vendosur t’i

mbyllim këto kopshte dhe t'i dezinfektojmë. Nesër do të testohen të gjithë fëmijët e atyre dy klasave për të parë a ka pasur ngjitje të virusit më tutje. Jemi duke punuar, ku janë kontaktet e tyre në mënyrë që ta kufizojmë shpërndarjen e virusit", ka thënë Ahmeti në një konferencë për media. Kryetari i Prishtinës ka thënë se tani për tani nuk do të ketë rikthim të menjëhershëm të masave të izolimit, ndonëse ka thënë se nuk do të hezitohet në mbylljen e kopshteve të fëmijëve apo lokaleve, që potencialisht mund të jenë vatra të përhapjes së virusit. Në Kosovë vetëm gjatë ditës së dielës janë regjistruar 40 raste të reja me Covid-19. Sipas të dhënave të fundit, në Kosovë që prej shfaqjes së rasteve të para me koronavirus më 13 mars janë regjistruar 1 234 raste dhe 31 pacientë kanë vdekur dhe 890 pacientë janë shëruar.



Kuvendi këtë të enjte do të shqyrtojë një varg projektligjesh

EPOKA
E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nën drejtimin e kryetares Vjosa Osmani, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën ka vendosur që seanca e radhës e Kuvendit të mbahet këtë të enjte, duke filluar në orën 10:00. Në këtë seancë pritet të shqyrtohen një varg projektligjesh si dhe pika të tjera të proceduara nga qeveria. Pritet shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/03, dt. 05.06.2020, me të cilin kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit, si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm, sipas nenit 22B të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitet, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan (MFT), Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombetar për Zhvillim (MFT), Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi

Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Dogana 2020" (MFT), si dhe Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Fiskalis 2020" (MFT).
Pikë e rendit të ditës i kësaj seance do të jetë edhe raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019. Këto çështje paraprakisht do të trajtohen në komisionet përkatëse parlamentare.
Kryesia e Kuvendit në këtë

mbledhje ka shqyrtuar edhe çështje të tjera nga fushëveprimitaria e saj. Kryesia ka proceduar për mendim në qeveri katër iniciativa ligjore të Kuvendit: Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Projektligjin për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e Pandemisë “Covid-19”, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësítë i

plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin 05/L-063, dhe me Ligjin 05/L-007 dhe Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Clirimtare të Kosovës.

Është formuar, gjithashtu, grupei punues për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit për periudhën 2021-2025, ndërsa është kërkuar kompletimi sa më i shpejtë i grupeve të miqësisë, Grupit të Grave Deputeteve, Grupit të Deputetëve të Rinj dhe Grupit të Deputetëve të Gjelbër

Deputetët e LV-së dorëzuan nismë ligjore për votimin e mërgatës në ambasada dhe konsullata

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

drejtën e tyre kushtetuese për të votuar në ambasada dhe konsullata të Republikës së Kosovës. "Mërgata përbën më shumë se 1/3 e popullsisë së tërësishme në Kosovë. Roli dhe kontributi i bashkatdhetarëve ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i rëndësishëm në jetën ekonomike dhe sociale e politike në Kosovë. Breth 700 milionë

euro në vit vijnë nga mërgata. Fatkeqësish, dhe jo për fajin e saj, roli politik i mërgatës është reduktuar shumë kur bëhet fjalë për përfshirjen e tyre në vendimmarje”, është bërë me dije në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje. Po në këtë njoftim është bërë me dije se me projektligjin e propozuar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje votue-




sit nga mërgata do ta kenë mundësinë që ta realizojnë të drejtën e vet kushtetuese gë të votojnë në ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës në vendet ku jetojnë.

Bien çmimet e prodhimit në Kosovë

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Në tre muajt e parë të këtij viti çmimet e prodhimit në Kosovë kanë pësuar rënje. Pjesa më e madhe vërehet te nxjerra e xehes së metalit dhe prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve. Kështu bëhet me dije në raportin "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, tremujori i parë 2020", i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Sipas ASK-së, çmimet e prodhimit që kanë pësuar rënje më të ulët janë prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës. "Çmimet e prodhimit në Kosovë pësuan rënje në një mesatare prej 0.2 përqindësh në mes të tremujorit të parë të viti 2019 dhe tremujorit të parë të 2020-s. Rënje më të mëdha, sipas degëve të veprimit tarive ekonomike, vërehen te nxjerra e xehes së metalit me 5.6 për qind,



prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve me 4.6 për qind, prodhimi i produkteve minerale jo metalike me 2.9 për qind, prodhimi i mobilieve me 2.2 për qind, prodhimi i pijeve me 2.1 për qind, prodhimi i metaleve

me 1 për qind, energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar me 0.9 për qind, prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përvëç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta

dhe materialeve të gërshetuara - thurëse me 0.8 për qind, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës me 0.5 për qind, prodhimi i pajisjeve elektrike me 0.5 për qind, grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë me

0.3 për qind dhe prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës me 0.2 për qind", thuhet në raport.

ASK-ja ka njoftuar se rënia është neutralizuar nga ngritja e çmimeve të prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkurës, prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përvëç makinerisë dhe pajisjeve. "Rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës me 7 për qind, prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përvëç makinerisë dhe pajisjeve me 2.6 për qind, prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove me 1.4 për qind, përpunimi i produkteve ushqimore me 0.7 për qind, xeheroret dhe guroret e tjera me 0.4 për qind dhe prodhimi produkteve kimike me 0.4 për qind", thuhet në raportin e ASK-së.

KEK-u shton masat mbrojtëse kundër përhapjes së pandemisë

EPOKA
ERE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.) ka shtuar masat mbrojtëse në vazhdën e përpjekjeve për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19. "Në këtë drejtim, u.d. kryeshefi ekzekutiv, Luigj Imeri, ka kontaktuar të gjithë kolegët të cilët kanë rezultuar pozitivë në testin për Covid-19, me ç'rast dy nga nëntë kolegët tanë kanë shprehur se kanë simptoma më të theksuara, njëri gjendet në spital për trajtim, ndërsa të tjerët gjenden në vëtitolim dhe në gjendje të mirë (pa simptoma) dhe stabile. Në anën tjetër, falë bashkëpunimit të

shkëlqyer me IKShPK-në, sot janë testuar edhe 46 nga 63 kolegët tanë që dyshohet se kanë pasur kontakt me kolegët që kanë rezultuar pozitivë me Covid-19", thuhet në komunikatën e KEK-ut. Për më tepër, Komiteti i Sigurisë në nivel të Korporatës dhe u. d. kryeshefi ekzekutiv, pas analizimit të situatës, kanë vendosur ta ndryshojnë orarin e punës në njësitë prodhuese DPQ, TCA dhe TCB. "Si rrjedhojë, tanë e tutje në prodhim do të punohet me dy ndërrime nga 12 orë, ndërsa në mirëmbajtje do të punohet në grupe vetëm në ndërrimin e parë gjithashtu me orar 12 orë, hap ky që do ta shmangë në masë lëvizjen e punëtorëve të cilët udhëtojnë nga të gjitha

trevat e Kosovës. Prandaj, menaxhmenti bën apel edhe një herë te të gjithë punëtorët që të jenë vigjilentë kudo që ndodhen në

respektimin e rekomandimeve të IKShPK-së, duke mbajtur distancën sociale dhe gjithashtu, përdorimin e pajisjeve të nevojshme

higjenike. Këto veprime janë të domosdoshme për ta parandaluar përhapjen e pandemisë", theksohet në komunikatën e KEK-ut.



Rukiqi, apel bizneseve: Respektojini masat ose mund të ktheheni në pikën zero

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka bërë thirrje që bizneset t'i respektojnë masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka thënë se "pas shumë përpjekjeve që kemi bërë për ta lejuar hapjen graduale të ekonomisë, gjithçka mund të kthehet në pikën zero". "Kemi bërë shumë përpjekje dhe mund për ta lejuar hapjen graduale të ekonomisë, por gjithçka mund të kthehet në pikën zero nëse masat përfundojnë, nuk respektohen,



sidomos në bizneset ku ka grumbullime dhe turma", ka shkruar Rukiqi. Ai ka thënë se bota ka filluar t'i kthehet normalitetit, por ky normalitet tanë i ka rregullat e veta. "Rregull mbi rregullat është kujdesi përveten dhe të tjerët, duke mbajtur distancën, duke mbajtur maskat (sidomos stafi) dhe duke bërë dezinfektim të rregullta. Mospërhapja e virusit dhe shkuanja drejt përfundimit zyrtar të pandemisë na lejon të fokusohemi në pjesën e masave për rimëkëmbjen e ekonomisë. Sa më shpejt që kemi përfundim zyrtar të pandemisë, aq më e shpejtë do të jetë rimëkëmbja ekonomike", është shprehur ai.

Nis faza e dytë e dezinsektimit hapësinor në kryeqytet

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Prishtinës ka filluar faza e dytë e dezinsektimit hapësinor në kryeqytet. Me këtë rast, kjo komunë ka latur qytetarët për bashkëpunim në mënyrë që ky aktivitet të jetë sa më i suksesshëm. "Gjatë kohës së

dezinsektimit qytetarët duhet t'i mbajnë dritaret e mbyllura që mos futen insektet brenda dhe t'i kufizojnë daljet nëpër hapësirat ku është duke u kryer dezinfektimi, së paku për një orë. Gjithashtu, apelohet te shoqatat e bletarëve për kujdes të shtuar gjatë kësaj periudhe. Monitorimi i këtij procesi nga ana e Komunës së Prishtinës do të jetë i vazhdueshëm dhe në bashkëpunim me qytetarët do ta japim maksimumin për një dezinsektim sa më efektiv", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Nis ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Jançisht të Malishevës

MALISHEVË, 8 QERSHOR (ER) - Jançishti është fshat i komunës së Malishevës, në të cilin të hënën kanë filluar punimet për ndërtimin e ujësjellësit. Në fillimin e punimeve kanë marrë pjesë edhe kryetari i komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Milazim Morina.

Begaj ka thënë se realizimi i këtij projekti ka rëndësi për banorët e këtij fshati. "Sot për ju banorë të fshatit Jançisht, por edhe për ne si institucionë udhëheqëse komunale, është një ditë e veçantë dhe e rëndësishme, sepse ta sigurosh ujin e pijshëm për banorët ke siguruar mirëqenien e njerëzve

dhe ke hapur rrugën për zhvillim ekonomik, pasi uji është aset qenësor për jetën e njerëzve", ka thënë Begaj. Ky projekt është duke u financuar Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC) dhe Qeveria e Kosovës, kurse implementohet nga konsorciumi "Dorsch&CDI".

Komuna e Skenderajt vazhdon implementimin e projekteve infrastrukturore

SKENDERAJ, 8 QERSHOR (ER) - Në kuadër të zhvillimit të projekteve infrastrukturore, për të krijuar kushte të favorshme për secilin qytetar të Komunës së Skenderajt, ka vazhduar asfaltimi i segmenteve rru-

gore në fshatin Kotorr. Punimet për realizimin e këtij projekti i ka inspektuar nënkyretari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, bashkë me stafin e Drejtorisë së Urbanizmit.



Tahiri inspektoi marketet, barnatoret dhe bizneset në Vushtrri



Publicisti Mustafë Ismaili vizitoi Komunën e Fushë-Kosovës

FUSHË KOSOVË, 8 QERSHOR (ER) - Publicisti dhe veprimtari i çështjes kombëtare, Mustafë Ismaili, i cili jeton dhe vepron në Toronto të Kanadasë, ka

vizituar të hënën Komunën e Fushë-Kosovës, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Burim Berisha. Ismaili është anëtar i shumë

shoqatave të shkrimitarëve shqiptarë kudo nëpër botë. Ka të botuara poezi, romane, reportazhe dhe udhëpërshtakime në gjuhën shqipe dhe

bizneseve që çdo gjë tashmë është e qartë, ose maska për personelin dhe konsumatorët ose mbyllje. "Do ta mbrojmë qytetin e qytetarët dhe këtë liri me çdo kusht. Shumica e qytetarëve dhe bizneseve janë bashkëpunues e të ndërgjegjshëm, prandaj kjo na e bën punën më të lehtë. Në Komunë, QKMF, gjykatë dhe në dyqane, nuk lejohet hyrja pa maska. Të mbash maskë nuk është marre, me përhap virusin edhe është marre, edhe është e kundërligjshme", ka thënë Tahiri.



angleze. Në fund të këtij takimi Ismaili ia ka dorëzuar Berishës disa nga titujt e veprave të tij të publikuara në gjuhën shqipe.

Lavdia u takon atyre që flijohen përvizione të mëdha



Bedri ISLAMI

Në vend të parathënies

Të shkruash një libër për familjen Jashari është ndër gjërat më të vështira. Për disa arsy, më e rëndësishmja nga të cilat është në përmasat e jashtëzakonshme të jetës së saj, në dimensionet që ka marrë ajo. Vetëjeta e tyre, e secilit dhe e të gjithëve së bashku, është më shumë se një vlerë, është bashkësi virtytesh të cilat tashmë janë pjesë e jetës së përditshme të shqiptarëve kudo që jetojnë.

Ajo që më ka befasuar në njojhet e para me to ishin disa video që u kishin nisur bijve të tyre në mërgim, pjesë nga jeta e tyre e zakonshme, tepër e zakonshme në një ditë, po ashtu të zakonshme, kur në kopshtin me mollë dhe pemë të tjera, ata, si të gjithë njerëzit e vdekshëm, luanin, çanin dru, mblidhni frutat, qeshnin me njëri-tjetrin, ngacmonin, përfundit përfunditshme në një dimension të pazakontë, bisedat tani bëheshin përgjëra të mëdha, rrëth vatrës, duke pasur nënën e tyre në mes dhe shokët e luftës rrëth e rrëth tyre, njeriu përgatitej se atë që mund të vinte më pas: të mbetnin në mend fjalët e mençura të Hamzës, qëndrimi stoik, i qetë i babait të tyre, Shabanit, përkëdhelia e nënës së tyre duke mbajtur në duart e saj të reshkura duart e bijve, qetësia deri në mermerizim i Adem Jasharit, afërsia me armët si të ishin gjymtyrë të trupit të tyre, e si përfundit dashur të kthehesin përsëri në të përditshmen, vallja me hapa të qetë e të rendë, sikur i dërgonin mesazh tokës dhe ngulnini këmbë se do të rrinë deri në fund vetëm aty.

Pastaj erdhë në Organizatë, në Lëvizjen Popullore të Kosovës, letra e fundit e tyre, në dhjetorin e vitit 1997, në të cilën si njeri i letrave më ra në sy shqipja e tyre, e shkruar mrekullisht, ku ishte e vështirë të gjeje gabime dhe modestia, ku asnjëherë, në ato gjashtë faqe letra, nuk përmendë askund emri i tyre apo se ata vëtë kishin qenë në atë përballje të nëntorit të vitit 1997 që, në fakt, ishte lufta e parë e hapur ndaj makinerisë serbe.

Prej shumë vitesh unë kam

shkruar përfundit e tyre. Duke filluar që nga shkrimi i parë, "A vdiq Adem Jashari", në mesin e marsit 1998, pak ditë pas ngjarjes heroike, i cili, përfundit hir të së vërtetës, ishte shkrimi i parë publicistik përfundit, por kurrë nuk kam mundur të them si duhet atë që kam ndier në vete time. E kam pasur të vështirë, ndoshta do ta kem edhe në të ardhmen, sepse pakkush mund t'i rrokkë, në të gjithë horizontet kah shtrihen, vlerat e përfjetshme të saj.

Edhe kjo që po paraqes sot, si pjesë e triptikut "E gjitha në shqip", është vetëm një sprovë tjetër, një afresë ndaj një dëshire të hershme, e cila, besoj, nuk është vetëm tek unë.

Dhe besoj se, si një sprovë, edhe do të vlerësohet. Sepse nuk është më shumë se kaq.

Për ta shkruar Librin e Jetës së Jasharëve duhet shumë më tepër.

Kurrë nuk më ka munguar dëshira, i jam afruar kësaj teme në të gjitha mundësitë që kam pasur, duke besuar se do të ketë një të ardhme tjetër.

Tashmë disa nga Jasharët janë kthyer në të përfjetshëm. Erërat fryjnë butësisht në fillimin e kodrës ku janë vendosur, në secilën pranverë fryn jugu që vjen nga dheu amë dhe pemët gjallërohen përsëri nga gjethet e blerta, lulëzojnë mollët dhe çelin lulet e qershive; atëherë të rënët patjetër kanë përfundit rindierë ringjalljen e pranverës.

Të rënët tanë janë tashmë pjesë e truallit të Kosovës: Ky është edhe shkaku pse toka e Kosovës kurrisë nuk mund të vdesë.

Ashtu si toka që nuk e di se çfarë është të vdesësh, ashtu edhe ata që mësuan se çfarë do të thotë të jesh i lirë pas një robërimi, do të dinë të kapen fort pas rrënjeve që jepen në emër të jetës. Përgjatë luftës njerëzit i mësuan mirë këto gjëra dhe do të kenë kurdoherë një arsy e fuqishme përfundit kujtuar. Të rënët janë prore pjesë e jetës sonë. Ata do të jetojnë po aq gjatë sa do të jetojë edhe toka e Kosovës. Kjo do të thotë përfjetësish.

Të rënët, që ndershmërisht çlodhen në dheun e butë të Kosovës, duke nuk ka të rënë përliri që të çlodhet më ndershmërisht se nën truallin e saj, ata pa dyshim i përkasin sojtit të përfunditshme.

Kjo sprovë është një nderim përfundit.

Tri kulla të vendosura pranë njëra-tjetrës, rrëthuar me një mur të ulët, të shfaqen sapo merr kthesën e parë drejt Prekazit të Poshtëm. Përmes një porte të madhe, e cila qëndron thuajse gjithnjë e hapur, hyjnë oborrin

e brendshëm të shtëpive, shtruar me gurë të bardhë. Mysafirët futen fillimisht në këtë rrëth, shikojnë me vëmendje gjithçka është rrëth e rrotull, si të duan t'i gjunjë gjurmët e gjithë asaj që ka ndodhur, kërkojnë përmes gjurmëve që kanë lënë gurët shenjat e gjakut që është derdhur, pastaj fillimet e vijëzimeve të reja të kalimit të njerëzve nga njëri cep në tjetrin dhe ngjiten ngadalë nëpër shkallët që të çojnë në katin e dytë.

Është e pamundur të ngjitesh nëpër këto shkallë qetësisht si nëpër shkallë të zakonshme ashtu si është e pamundur që të mos mendosh përgjithë atë që ka ngjarë, jo vetëm në ngastrat e tri kullave, por në të gjitha lagjet që përbëjnë Prekazin e Poshtëm. Dashur padashur të ndjekë e gjitha ajo që ka mësuar deri më tani përfundit, të duket sikur ndien ende gjëmimet që kanë ndodhur e megjithatë, je i qetë dhe ndihesh mirë. Qetësinë dhe mirësinë, edhe pas kaq viteve, ta jepin ata që ndodhen përballë kullave, në kodrën bri fshatit, të përfjetshëm dhe njëkohësisht hijerëndë. Në fund të fundit e di se ndodhesh në një vatër ku të dhurojnë qetësi ku, me gjithë rrëmetet e përgjakshme, asgjë nuk e ka tronditur jetën e përfunditshme, të zakonshme.

Ka edhe një hyrje tjetër, më të vogël, bri portës së madhe. Një derë e drunjë të fton të njëjtesh sipër, pa shkuar përmes oborrit të gurtë, drejt përsëdrejtë në dhomën e miqve.

Por ngado që t'i biesh, qoftë nga porta e madhe, apo nga dera e drunjë, do të ndihesh njëlljo i qetë, i mirëpritur dhe mrekullisht edhe më i mirë. Sepse këto kulla kanë edhe çudinë e fisnikërimit të

njerëzve.

Nuk ka qenë gjithnjë kështu. Në mesin e qershorit të vitit 1999, kur isha përfundit tjetër të Prekazit e Poshtëm, mik tek Jasharët, kullat ishin të shembura dhe të djegura, trentë e kulmeve kishin rënë përmbyt mbi vatrën ku ngrohej shpirti, vende-vende të dukej sikur ende tymrat mbulonin çdo gjë që ishte përreth, nëpër oborr kishte ende gëzhoja fishekësh dhe mbetje të plasjeve të bombardimeve, ujët rriddhë nëpër ngastrat e vogla dhe çdo gjë ishte e pazakontë.

Atëherë ishte e zakonshme të shkelte këmba mbi copërat e luftës ashtu si ishte ende e zakonshme që nëpër gjumë të të shfaqeshin lemeritë që sapo kishin shkuar. Mirëpo, këto kishin gërmadha jo të çdo lloji, por me një fat të çuditshëm. Po të gërmojë poshtë tyre do të gjeje gjëra të pazakonta, fillimisht nën muranën e gurëve dhe të traëve do të gjendej automatiku i Ademit pastaj, pas luftës, një ditë fundqershorë 1999, në gërmadhat e shtëpive të bombarduara do të gjendej automatiku i Hamzës, diku më tej armë të tjera, ende me tytat e nxira nga lufta.

Edhe kjo nuk kishte qenë pamja e tyre, këtë e kishin bërë vrasësit serbë, me gjithë makinerinë e tyre të furishme, të përgjakshme dhe të llahtarshme. Gjurmët e luftës që ishin krejtësisht të pambuluara, të shfaqeshin befasisht ne çdo cep, disa prej të cilave i sheh edhe sot në kullën e parë muze, por nuk ishte vetëm kjo. Kur po u afrohesha kullave të gurta, rrafshuar deri në themelin e tyre, përmbrushur nga bloza dhe tmerri i luftës, përmes rrënojave dhe gurëzimit të gjithkahshëm, kishin filluar të mbinin fijet e barit. Si të kish rilindur jeta.

Në ditët e para, fundqershorë 1999, Jasharët kishin zënë vend në një banesë të vogël në fundin e oborrit, ku në një dhomë të madhe, shtruar përkohësisht me qilima, prisnin njerëzit që vinin përfundit.

Me djemtë, Muratin, Lulzimin dhe Bekimin, kishim udhëtarë së bashku nga Gjermania deri në portin e Barit, në Itali. Pastaj, së bashku me Rifat Jasharin, kalaum të parët detin, me një traget të shpejtë, ndërsa djemtë do të vinin të nesërmen. Arritëm disi vonë në Durrës, udhëtuam nëpër muzgun e asaj dite qershorë dhe bujtëm te Shaban Sinani. Shabani kishte asaj kohe, nuk e di tani, një banesë të vogël, dydhomëshe. Aty gjetëm edhe Beqir Beqën, mikun tim gazetar. Të zotët e shtëpisë, tepër bujarisht, si edhe hera të tjera, na bënë konak, por më përpëra lëvizën të gjitha mundësitet përfundit ta përgatitur pritjen e Jasharëve në portën e Durrësit. Ishte vonë, megjithatë përmes drejtës së përgjithshëm të RTSh-së, Eduard Mazi, ndër më të merituarit në mbështetjen e UÇK-së, u bë gjithçka gati përfundit e nesërme. Aty u ndava me Rifat Jasharin, unë udhëtova përfundit Kosovë që në pikun e mëngjesit, së bashku me Beqirin, pasi më duhej të isha në Mbledhjen e Përgjithshme të LPK-së që zhvillohej asaj dite në Prizren.

Të pasnesërmen, së bashku me Hashim Thaçin, në zyrën e vogël asaj kohe të Sami Lushtakut, pritëm ardhjen e Jasharëve pastaj, kur nuk po mund të rrinim më në pritje, morëm rrugën drejt Prizrenit, përfundit luftës, përmes rrënojave dhe gurëzimit të gjithkahshëm, kishin filluar të mbinin fijet e barit. Si të kish rilindur jeta. (Vijon)



Zelanda e Re, zero raste aktive, heq masat kundër Covid-19

WELLINGTON, 8 QERSHOR - Zelanda e Re do t'i heqë pothuajse të gjitha masat kundër koronavirusit pasi nuk ka më asnjë rast aktiv. Nisur nga mesnata e sotme, sipas kohës lokale, distancimi fizik nuk do të kërkohet më dhe nuk do të ketë kufizime

në tubimet publike. Kufijtë, megjithatë, do të mbeten mbyllur. Zelanda e Re nuk ka raportuar raste me Covid-19. Kryeministrja Jacinda Ardern tha se "ka vallëzuar pak" kur i është thënë se vendi nuk ka më

raste aktive me koronavirus. "Edhe pse jemi në pozitë më të sigurt dhe më të fuqishme, nuk ka ende rrugë të lehtë për t'u kthyer në jetën e para Covid-19", tha Ardern, duke shtuar se "vendosmëria që kemi pasur në përgjigjen tonë shëndetësore,

tani do të përqendrohet në rindërtimin tonë ekonomik". Zelanda e Re është izoluar më 25 mars, duke mbyllur shumicën e bizneseve dhe shkollat, ndërsa njerëzve u është thënë të qëndrojnë në shtëpi. Pas më shumë se pesë javësh ka



nisur të rihipet gradualisht. Zelanda e Re ka konfirmuar 1 154 raste me koronavirus dhe 22 viktima.

Tre të vdekur dhe 127 raste të reja me Covid-19 në Maqedoni


SHKUP, 8 QERSHOR - Në Maqedoninë e Veriut të hënën janë regjistruar shifra rekordë të të infektuarve me koronavirus.

Ministri i Shëndetësisë së Maqedonisë së Veriut, Venko Filipiç, ka njoftuar se nga testimi i 702 mostrave, 127 persona kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, sëmundjen që e shkakton koronavirusi, ndërsa tre persona kanë ndërruar jetë.

Viktimat janë një burrë 70-vjeçar nga Kumanova dhe dy nga Shkupi të moshës 62 dhe

78-vjeçare, me çka numri i përgjithshëm i të vdekurve nga koronavirusi ka arritur në 156. Nga të infektuarit, sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë, 67 janë nga Shkupi, 33 në Shkopje, 10, Ohër 6, Strugë 5, Probishtip dhe Koçan 2, ndërsa në Dibër dhe Kumanovë nga 1 rast. Zonat me më së shumti raste me koronavirus në Shkup janë komuna e Çairit, Qendra dhe Buteli. Që nga paraqitja e koronavirusit, në Maqedoninë e Veriut janë testuar 37 027

mostra për Covid-19 dhe pozitiv me koronavirus janë 3 152 persona. Numri i të shëruarve ka arritur në 1 653, ndërsa raste aktive janë 1 343. Numri i madh i infektimeve kanë ndodhur në dhjetë ditët e fundit edhe për më shumë se 900 raste. Komisioni i Sëmundjeve Infektive i ka propozuar qeverisë aplikimin e orës policore në vratat e përhapjes së virusit si në Shkup, Tetovë, Kumanovë dhe Shkopje. Ndalimi i lëvizjes së qytetarëve është propozuar nga ora 22:00 deri në orën 05:00.



Autoritetet amerikane kërkojnë intervistimin e princit britanik Andrew

NJU JORK, 8 QERSHOR - Departamenti amerikan i Drejtësisë është duke kërkuar ta marrë në pyetje Princin Andrew të Britanisë së Madhe, në kuadër të hetimeve për dyshimet rreth bashkëfajësisë në komplot me financierin tashmë të vdekur dhe të dënuarin për krime seksuale, Jeffrey Epstein, ka thënë një zyrtar i zbatimit të ligjit në Shtetet e Bashkuara, transmeton "Reuters".

Hetuesit amerikanë kërkojnë të intervistojnë, Andrewn, djalin e dytë të Mbretëreshës Elizabetë, rreth shoqërisë së tij me Epsteinin, i cili është gjetur i vdekur në burg vitin e kaluar, teksa ka qenë duke pritur akuzat për trafikim të të miturave, ka thënë ky zyrtar në kushte anonimiteti.

Gazeta britanike "Sun" ka raportuar të hënën se



Departamenti Amerikan i Drejtësisë u ka dërguar autoriteteteve britanike një kërkesë, që lidhet me hetimet penale, me qëllim të mbledhjes së materialeve në shtetet e

tjera, të cilat nuk mund të sigurohen nga bazat e bashkëpunimit policor. Një zëdhënëse e këtij Departamenti dhe Pallati Buckingham në Britani nuk

kanë pranuar të komentojnë këtë çështje. Andrew, 60-vjeçar, nuk është akuzuar për asnjë keqbërje, është thënë në një deklaratë publike të muajit nëntor, kur ai

ka hequr dorë nga detyrat publike si pasojë e zemërimit të ngritur për lidhjet e tij me Epsteinin.

Atëbotë ai është thënë se ka gatishmëri për të ndihmuar "nëse ndonjë agjenci e duhur e zbatimit të ligjit i kërkon ndihmë në hetime".

Në muajin mars, prokurori i Manhattanit, Geoffrey Berman, ka thënë se, pavarësisht prej deklaratave publike të princit britanik, ai "ka mbyllur derën për bashkëpunim vullnetar andaj zyra jonë është duke i shqyrta mundësitet".

Nëse pranohet kërkesa amerikane nga autoritetet britanike, atëherë prokurorët e ShBA-së do të mund t'i kërkojnë princit Andrew që vullnetarisht të marrë pjesë në një intervistë, apo mund edhe ta detyrojnë që të ofrojë të dhëna në gjykatë, nën betim.

Powell: Trumpi "ka dalë nga Kushtetuta"

UASHINGTON, 8 QERSHOR - Ish-sekretari amerikan i Shtetit, Colin Powell, kritikoi ashpër presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, përmënyrën se si i ka adresuar protestat kundër racizmit në ShBA.

Powell, republikan dhe ish-oficer i lartë ushtarak, tha se Trump "ka

dalë nga Kushtetuta". "Ne kemi kushtetutë dhe duhet ta ndjekim atë, por presidenti është larguar prej saj", tha Powell për rrjetin televiziv CNN.

Powell tha se në zgjedhjet presidenciale të nëntorit në ShBA do ta votojë rivalin e Trumpit, kandidatin demokrat Joe Biden.

Trump reagoi duke thënë se

Powell është "tepër i mbivlerësuar".

Powell, afrikano-amerikani i vetëm që ka shërbyer si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë amerikane, i është shtuar një liste të gjatë të zyrtarëve që kanë dënuar përgjigjen e Trumpit ndaj protestave.

ShBA-ja qyshtë fund të majit

është përfshirë nga protestat kundër racizmit për shkak të vdekjes së një afrikano-amerikani në duart e polisë.

Trump i ka cilësuar protestuesit si "anarkistë profesionistë, plaçkëtës, kriminelë" dhe ka kërcënuar se do ta përdorë ushtrinë kundër tyre.

Powell tha se retorika e presi-



dentit është rrezik për demokracinë amerikane.

Beppe Costa: Të ngresh një tempull përmes fjalës

Nga Luan RAMA

Tempulli që prej më shumë se gjysmë shekulli ka ngritur poeti italian Beppe Costa, nuk u përengjan tempujve historikë. Eshtë një tempull i fjalës, ngritur përmes fjalës, «le verbe», poeziës në fjalë shpirti e revolte, një tempull jo thjesht për veten por për ty dhe mua, për njeriun e thjeshtë, atë që do librin dhe lirinë, atë që vuani dhe kërkon të mbajë gjallë shpresën. Eshtë një tempull tjetër, një tempull i dashurisë solidare, një tempull i paqes dhe i anti-luftës, një tempull që kërkon të krijojë dhe mbrojë shpresën e të ardhmes në të gjitha skajet e botës.

E njoha këtë poet në festivalin poetik ndërkombe tar të Rahovecit, mes poetëve irlandeze, slovenë, boshnjakë, japonezë, amerikanë, islandezë, etj., dhe menjëherë ndjeva se ky poet vuante shumë. Më ngjante se kishte ngjitur një pikë mali dhe që andej shikonte botën dhe i vinte keq për betejat e tij dhe të poetëve të tjerë të Italisë dhe poetëve të botës, pasi poshtë, bota ende ishte zhytur në pellgun e mjerimit, të indiferencës, të urejtjes dhe shfrytëzimit, të kufijve të pakapërcyeshëm, mureve, të ndasisë dhe të egocentrizmit, bota që priste gjithnjë atë shkundje të madhe që duan poetët, ata të revoltës, sic është Beppe Costa. Ky siçilian që shkroi poezi që në moshën 8 vjeçare, që u end midis poezisë, muzikës dhe antifashizmit, duke botuar librat e parë dhe duke spikatur më pas në vitet '80-'90 me librat e tij poetikë e romane, krijoj një vepër të gjerë, shumë dimensionale: poetikë, gazetari, romane, këngë, video, sic kemi qejf ta

dëgjojmë, kur me zérin e tij të ngjirur reciton poezi të tijat dhe të miqve poetë, të poetëve që i këndojnë botës dhe dashurisë humane, të poetëve që dinë t'i rrahin kambanat e alarmeve për një botë tjetër. Bukur e thoshte mikja e tij Barbara, se që nga «Romanzo siciliano» Beppe Costa i ka paraprirë shqetësimit njerëzimit dhe katastrofës morale që e kërcënonte. Sot po ato probleme ngrihen para botës: luftërat me shteteve, pushtimet arbitrale, dhunat dhe diktaturat, organizatat mafioze e kriminale, lufta që i bëhet gjithnjë lirisë. E megjithatë Beppe ka vazhduar gjithnjë me poezinë e rrugës, poezinë e protestës, duke na kujtuar Pasolinin që aq shumë e adhuronte.

Kur u takova me të, nuk e dija veprën madhore të tij, nuk i njihja përkthimet që i kishte bërë në italisht dramave të forta të spanjollit Francesco Arrabal, gjithnjë në të njëjtën llogore, por shpejt mësova se si ky poet ngrihej kundër luftës dhe shtypjes kundër njeriut, shfrytëzimit të tij; kuptova se si ky poet kërkonte e kërkon një moral të ri për botën, që bota e qytetëruar nuk po arrin ta krijojë. E megjithatë poetët dinë të mos tërhiqen, të mos trishtohen. Ata dinë t'u bien kambanave të tyre poetike. Jo më kot, me ardhjen e tij në Romë më 1976 dhe krijimin e shtëpisë së tij botuese «Pelicanolibri» (dhe më 1992 «Libraria Pilllicanolibri»), shumë intelektualë ishin të ftuarit e tij, aty ku ishte skena popullore, aty ku poezia lexohej në shkolla, në, në baret e qytetit dhe sheshet, që dhe njeriu i thjeshtë t'i bashkohej thirrjes poetike, të ndjente atë ndjeshmëri të botës dhe dashurisë që ekzistonte. Aty



erdhën Monika Viti, këngëtarë Don Back që aq shumë e kemi dëgjuar në vitet '70-'80 bashkë me Batistin, Morandin apo Ranieri, e shumë të tjerë. Ishte mik i Alberto Moravias, të cilin e intervistonte në Romë siç intervistonte Senghor e shumë të tjerë të mëdhenj të poezisë botërore; mik i Arabal me të cilin rrahu udhët e Italisë, mik i Dario Bellezza, Adele Cambria, Arnoldo Foà, Anna Maria Ortese... Poet dhe botues, fitues i çmimit "Alfonso Gatto" për poezinë (2017), ai botoi vepra të autorëve të shquar europianë si Manuel Vasquez Montalban, Gaston Bachelard, Gisele Halimi e autorë të ditëve tona. E gjen atë në shumë nga antologjitë poetike botërore, i përkthyer në shumë gjuhë si dhe në anglisht, spanjisht, frëngjisht, arabisht... Miqtë e Beppe-s janë të shumtë. Janë në gjithë botën, sepse Beppe është një poet i tokës dhe i jetës, një poet i dashurisë siç këndon dhe në veprën e tij të njojur "Il poeta chi amava le donne" (Poeti që donte gratë)... dhe që i do të gjithë: të thjeshtët, të pambrojturit, të varfrit, homoseksualët, të droguarit që

do t'i nxjerrë nga ajo mizerje ku kanë rënë. Beppe di t'i klithë dashurisë, pasi ashtu ka klithun gjithnjé ai, që në rini të tij. Këtij njeriu ai do t'i japë shpresë madje dhe atë që ka marrë armën dhe që e kanë çuar me dhunë të luftojë e të bëjë një luftë të padrejtë. Këtë njeri ai do që ta kthejë dhe t'i thotë se éshtë paqja pér të cilén duhet luftuar. Edhe pse vetë éshtë në "shkallaret e fundit" siç flet përmes tij, ai e di se të tjerët vijnë dhe ngjisim shkallët e poezisë dhe të luftës përmes progresin dhe solidaritetin njerëzor, gjeneratat e reja pér të dhënë frymë kësaj bote të sémurë dhe që jo rrallë dergjet në deliret e pushtetarëve, perandorëve, diktatorëve.

Sa i thjeshtë aq dhe i habitshëm përkujtimi që Beppe i bën mikut të tij, poetit palestinez Naim Araidi, vdekur para disa kohësh, me vargjet pér të: "Koha e dhimbjes nuk kalon / ajo mbetet e ngjizur, therrëse gjatë natës/ duke menduar pér ty miku im/ ne nuk e njihni gjuhën e njéri-tjetrit/ por poeziat rridhte....» Beppe, ky poet i dashurisë dhe revoltës sic e

luftës në poetikën e feniksit. Kishte shumë diell atë ditë në Prizren. Kishte shumë diell dhe në shtëpinë e Namik Hotit e po kështu nga ato qindra varre që pa në tokën e Kosovës dhe që shkroi për to, siç shkroi dhe për sheshet e revoltës shqiptare dhe masakrës serbe.

Po, të ngresh një tempull nuk është lehtë. Dhe Beppe, i sëmurë tashmë, i lodhur nga trupi, por jo nga shpirti, Beppe që nuk dorëzohet, ai vazhdon të këndojet: "tani vetëm mund të mendoj / se si vështrohet deti në dimër / kur dallga mund të më lagë...". Ai di ta mbajë gjallë këtë tempull përmes sakrificës. Ai e di që të parët që sakrifikojen, ashtu siç ishte një Lorca, një Ricos e shumë poetë të tjera. Ja pse në themelat e atij tempulli, është gjaku dhe fryma e tij, i poetëve, është ai shpirt i trazuar që nuk do t'i largohet kësaj bote pa parë rrezen okër të diellit që të shfaqet në horizont, atë diell që do t'i sjellë botës paqen, të një bote pa luftëra, ku bashkëpatriotët e mikut të tij palestinez Naim Aridi të jetojnë në paqe me pinjollët e poetit izraelit Amishai... Eshtë Beppe Costa që vitet e fundit, pas vizitave të tij në Shqipëri, nga Tirana në Durrës, në Vlorë, Sarandë e gjetkë, duke sjellë poetë italianë dhe takuar poetë të shumtë shqiptarë, ka krijuar atë urë të bukur që përshkon Adriatikun, atë urë poetike zérash e vargjesh. Dhe shpesh urat poetike, ato të shpirtit, janë më të forta se urat e gurit, hekurit dhe betonit.

Beppe Costa, ky adhurues i Rembosë, Eluarit, Preverit apo Paul Valery, do të ishte një poet mirëpritur në Shqipëri dhe padyshim popullor dhe përfaktin se sa i fuqishëm ai është në planin social, aq është dhe lirizmin e tij dhe poezitë e dashurisë. Do ishte mirë që POETEKA ta ftonte në faqet e saj e po kështu dhe mediat e ndjeshme ndaj poezisë./ *Gazetashqiptare*



E rrallë

Shitet për 21 milionë dollarë apartamenti në kullën bregdetare në Florida

Një apartament, kat i plotë, në rezidencën bregdetare Ritz-Carlton në plazhin e Floridas, është shitur për 21 milionë dollarë, kanë njoftuar ndërtuesit. I shtrirë në të gjithë katin e 51-të të kullës 52-katëshe, apartamenti ka rreth 1 000 metra katrorë veranda e ballkone, kuzhinë verore, pishinë e kopsht privat.



hapësirë të brendshme, duke përfshirë katër dhoma gjumi, ambiente stafi, shtatë banja, kinema, palestër dhe magazinë. Apartamenti ka rreth 1 000 metra katrorë veranda e ballkone, kuzhinë verore, pishinë e kopsht privat.

FOTO E DITES




Artisti filipinas me shishe të plastikës dizajnon një maskë në formën e virusit Covid-19.

E jashtëzakonshme

Zbulohet thesari i fshehur dekada më parë në malet shkëmbore në ShBA

Thesari që kap vlerën e një milion dollarëve, i fshehur në malet shkëmbore në ShBA nga Forrest Fenn dekada më parë, më në fund është gjetur. Qëkur Fenn, tani 89-vjeçar, pati deklaruar se kishte fshehur një thesar, mijëra gjuetarë të thesareve ua kishin mësyrë maleve Rockies duke shpresuar se do ta gjejnë, madje pesë burra kishin humbur jetën duke tentuar ta gjejnë. Por



sënduku i brontzë brenda të cilit kishte monedha ari, stoli të ndryshme si dhe diamante, është gjetur nga një eksplorues i cili vazhdon të mbetet anonim për opinionin publik.



DASHI
Qielli i kësaj dite nuk do të jetë shumë inkurajes nga pikëpamja profesionale dhe disa re mund ta errësojnë horizontin e atyre që punojnë në grup me të tjera.



DEMI
Do të punoni shumë për t'i rritur burimet dhe për të ndërtuar diçka për të ardhmen, veçanërisht nga pikëpamja profesionale.



BINJAKËT
Asnjë ide e re nuk do të jetë e nevojshme tani: vetëm një përpjekje e vogël, një intuito e vogël, është e mjafsheshe për të kuptuar se ku dhe si duhet të veprosh.



GAFORRJA
Bëni gjithçka vetë dhe mos pranon këshilla, madje as gjykimet! Një pengesë e mundshme në marrëdhënien tuaj me partnerin duhet t'ju shqetësojë.



LUANI
Sot do jetë një ditë e qetë për t'i përkushtuar rëndësi dhe kohë hobit, dashurisë dhe punës suaj. Marrëdhënia juaj e dashurisë do të jetë e fortë si shkëmbi dhe një problem familjar do të zgjidhet.



VIRGJËRESHA
Ju keni një besim të madh në veten tuaj dhe mundësitë që ju ofrohen. Do të karakterizoheni nga një optimizëm i madh.



PESHORJA
Nëse keni mendime të kundërtat me familjen tuaj, është e kotonë t'i insistoni, nuk do të jeni në gjendje ta ndryshoni mendjen e atyre që nuk mendojnë si ju.



AKREPI
Ditë dinamike dhe pozitive. Në kohën tuaj të lirë do të doni të takoni njërit të rinj dhe të viziton vendet e panjohura.



SHIGJETARI
Duhet të keni besim tek instinktet tuaja dhe të ecni përparrashpejt, gjithashtu falë mbështetjes së miqve tuaj më të afërt.



BRICJAPI
Në punë do të keni pa dyshim fat, mund të fitoni edhe diçka në lojë. Jeta në çift do të ketë dinamizëm dhe ide të reja për të mos u mërzitur kurrë.



UJORI
Ditën e sotme ju do t'i sqaroni një personi qëllimet tuaja të vërteta dhe varet në dorën e tij nëse do vazhdojë të qëndrojë pranë jush apo jo.



PESHQIT
Ka shumë pritshmëri për projekte të reja që mund të rezultojnë të favorshme për të ardhmen. Keni besim në punën tuaj!

BARSOLETA E DITËS



- Mbrëmë gruas tënde i tregova një barsoletë.
- Dhe si reagoi ajo?
- Qeshi aq shumë sa ra nga krevati.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 **Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 **Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 **STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams

Çdo natë në ora 22:30 **THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Kim dhe Kanye drejt divorcit



Cifti i njohur Kim Kardashian dhe Kanye West së fundmi janë bërë temë diskutimi në mediat rozë, e gjithë kjo për shkak të një sherri në karantinë i cili gati sa nuk çoi deri te divorci. Sipas medave të huaja, thuhet se sherri mes tyre ka nisur gjatë periudhës së

karantinës, pasi Kimi i ankohej vazhdimisht se nuk po e ndihmonte aspak me fëmijët. Kimi ishte shprehur e revoltuar dhe se ndihej tejet e lodhur dhe e mbingarkuar, pasi gjatë asaj periudhe ajo nuk kishte mundësi të punësonte një dado përfëmijët për shkak të distancimit fizik.

Albumi “Chromatica” i Lady Gagas, më i shituri në 2020-n



Këngëtarja Lady Gaga njihet për çmimet e marra, mirëpo edhe këtë vit ka ecur mirë pasi albumi i saj më i ri që mban emrin “Chromatica” është renditur i pari si më i shituri në Mbretërinë e Bashkuar.

Sipas BBC-së, Lady Gaga deri tani ka shitur 53 mijë kopje. Gaga ka folur haptas se ka vuajtur nga sëmundjet kronike dhe depresioni. Ajo ka treguar se albumi kishte për qëllim të ishte një antidot përkohët e vështira.



David Beckhami planifikon realizimin e emisionit të gatimit

Po flitet që ish-futbollisti David Beckham është në bisedime me “BBC”-në dhe Netflix për krimjin e një emisioni të gatimit i cili do të zhvillohet nga kompania e tij, “Studio 99”, shkruajnë mediat e huaja. E gjithë kjo ide besohet se lindi pasi aftësitet e tij në kuzhinë janë përmirësuar dukshëm gjatë periudhës në karantinë. “Një prej

dobive të rastësishme të karantinës për Davidin ishte mundësia për ta bërë atë që e pëlqen më së shumti e që është gatimi. Ai i ka rikrijuar disa prej recetave të vjetra të nënës së tij dhe së fundmi si dhuratë përditësindje i ka pranuar shumë enë të kuzhinës”, citohet të ketë thënë një burim i afërt i Beckhamit për “The Sun”.

Askush nuk e priste, James Bondi bëhet baba në filmin e ri



Kur flitet për 007, të gjithë mendojnë menjëherë aventurat e rrezikshme të agjentit më të famshëm në botë, pajisjet e çuditshme që e ndihmojnë në çaste të vështira dhe, sigurisht, vajzat bukuroshe që e rrëthojnë. Por në filmin më të fundit të sagës, James Bond duket është shtruar e do të shfaqet si një baba i përkushtuar i një vajze pesëvjeçare. Filmi, i vonuar deri në nëntor për shkak të mbylljes së kinemave prej koronavirusit, do të tregojë se si e dashura e Bondit, doktoresha Madeleine Swann, e interpretuar nga Lea Seydoux, ka sjellë në jetë një vajzë.



Shqipja e shkruar – ‘terra incognita’ në fillimshekullin XIX

Nga Dr. Jorina KRYEZIU
(Shkreta)



Në librin e albanologut dr. David Hosaflook, *Lëvizja Protestante te shqiptarët: 1816–1908*, trajtohen çështje të shumta e me larushi, duke filluar nga konteksti teologik, historik dhe shoqëror i Lëvizjes Protestante te shqiptarët, Dhiata e Re për herë të parë në gjuhën shqipe, veprimtaria ungjillore përkrah veprimtarisë arsimore, arsimimi i femrës shqiptare, përpjekjet e njëkohshme të Lëvizjes Protestante dhe Rilindjes Kombëtare Shqiptare e deri te botimet e ndryshme në gjuhën shqipe dhe përhapja e tyre anembanë trevave shqipfolëse, përfundimtar i përfundimtar i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (BFBS, British and Foreign Bible Society), përlëvrimin e gjuhës shqipe, si dhe gjeneza e shpërndarjes masive të botimeve shqipe, përmes strategjisë së librashitësve shëtitës. Duke qenë se shqipja në fillimshekullin XIX ishte një gjuhë e palëruar, ata erdhën jo vetëm me shkrimet e shenjtë në shqip, por edhe në të dyja dialektet, fillimisht në toskërisht e më pas në gegërisht. Edhe pse pikësynimi fillestar dhe ai përfundimtar i Shoqërisë Biblike ishte pa dyshim *ungjillëzimi* – përmes përkthimit të shkrimeve në gjuhën amë (si përbushje e

parimit *Sola Scriptura*) dhe shpërndarja masive të tyre, ata ndikuani edhe në lëvrimin e shqipes së shkruar. Misionarët protestantë erdhën në trojet shqiptare kur ende nuk ishte shfaqur ndonjë lëvizje arsimore apo të kishte ndonjë rrjet shkollash në gjuhën shqipe. Kështu, sot na duhet t'i shprehim mirënjojet më të thella misionarit protestant Robert Pinkerton – i cili qe i pari që i bëri shqiptarët objekt të BFBS-së – dhe gjuhëtarit Jernej Kopitar – i cili hodhi idenë e përkthimit të Bibliës edhe në gjuhën shqipe. Libri *Lëvizja Protestante te shqiptarët: 1816–1908* dritëson disa prej të dhënavë kryesore mbi botimet në gjuhën shqipe dhe përpjekjet e misionarëve të huaj: William Jowett, H. G. O. Dwight, William Schaufler, Jonas King, Rufus Anderson etj., dhe më pas atyre shqiptarë: Gjerasim, Qiriazi, Gjon Ciko, Gjergj Qiriazi etj., për kombin tonë dhe ndriçimin e tij shpirtëror e arsimor njëherazi. Populli shqiptar do të ishte gjithnjë e në interes për të shpërndarë Shkrimet e Shenjtë, të cilat do të ndiqeshin prej proceseve që do të ndihmonin arsimin në gjuhën amë, madje Nathalie Clayer në librin e saj *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, shprehet se: "...përrapa se të vinin protestantët, asnjë grup tjetër nuk kishte bërë përpjekje kaq serioze për botimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe". Misionarët protestantë kishin pikëpamje tepër të përpuruara për kohën, madje shpesh u ndeshën edhe me kundërshtime të autoriteteve fetare ose atyre

shtetërore, të vendeve ku ushtronin veprimtarinë e tyre. Përveç shpërndarjes së Shkrimet e Shenjtë në gjuhën amtare, ata në mënyrë të tertiortë ndikuani edhe në çështjet kombëtare, përmes shpërndarjes së abetareve dhe gramatikave, arsimimit të të dyja gjinive, si dhe barazisë arsimore dhe shpirtërore te njerëzit e thjeshtë. Sipas D. Hosaflook "shqëritë misionare protestante hynë në territorët shqiptare me qëllim për të botuar dhe për të shpërndarë Shkrimet e Shenjtë në shqip, për të nisur shërbimet ungjillore në gjuhën shqipe, si edhe për të hapur shkolla në gjuhën shqipe. Me këto veprimtari, ata konsideroheshin se po ndihmonin shqiptarët për t'u shqiptarizuar". Përparrimi social, zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare dhe ndriçimi letrar ishte pjesë e qenësishme dhe e pandërrerë e besimit fetar që ata përfaqësonin. Prof. Ferit Duka, në parafjalën e librit, shprehet se: "Protestantizmi për shqiptarët nuk ka qenë thjesht besim, por edhe një nxitës i fuqishëm i zgjimit kulturor dhe i përpjekjeve për arsim në gjuhën amtare, një urë e fortë komunikimi e shqiptarëve me qytetërimin perëndimor. Misionarët e këtij besimi në Shqipëri kudo që shkuani, mbollën jo vetëm dashurinë për Zotin, por edhe dashurinë për gjuhën shqipe dhe respektin për vlerat e kombit shqiptar." Deri më sot është folur gjërisht për fillet e shqipes së shkruar po dhe për botimet e para në gjuhën shqipe, por, përgjenezen e shpërndarjes

masive të botimeve, strategjitet e përdorura, përpjekjet e njëkohshme për *Shkrimin e Shenjtë* dhe *shqipen e shkruar*, nuk është folur kaq gjërisht përmes faktesh e dëshmish të shumta, duke plotësuar atë mozaik që nisi të zërë fill me zbulimet e prof. Xhevët Lloshit në Arkivat e Londrës, me punën e Xhon Kunarudit e të studiuesve të tjerë. Por, natyrshëm lind pyetja, se cili qe shkaku kryesor që i çoi këta përfaqësues në ndërmarrje kaq të mëdha, të cilat ndihmuani edhe në proceset e bashkimit kombëtar dhe të arsimimit në gjuhën amë dhe, në veçanti, të arsimimit të femrës shqiptare dhe të emancipimit të saj. Ajo çka i shtyu misionarët drejt trojeve të largëta gjeografike e kulturore, ishte pikërisht shpërndarja e tij ende nuk ishte prioritet i ndonjë botuesi. Kujtojmë se më 1824, botimi dygjuhësh greqisht-shqip i *Ungjillit sipas Mateut* nga BFBS-ja, i përkthyer nga Vangjel Meksi dhe i redaktuar nga Grigor Gjirokastriti), hapi një udhë të re për shqipen e shkruar, edhe përfaktin se do të shpërndarë kudo ku flitej shqip, duke e bërë atë "një gjuhë të gjallë dhe të përdorur" (M. Frashëri, *Diturija*, 1 janar 1909), ndërsa *Dhiata e Re* dygjuhësh greqisht-shqip, më 1827, po nga dyshja V. Meksi dhe G. Gjirokastriti, do të cilësohej pas 100 vjetësh si "udhëheqëse për shkrimin e shqipes" (M. Frashëri, *Diturija*, nr. 7, 1927). Përpjekjet e njëkohshme e të pandashme, si dy anët e një medaljeje, të Shoqërisë Biblike për Shkrimin e Shenjtë dhe për shqipen e shkruar, parashtron në këtë libër tepër gjërisht përmes faktesh e dëshmish, shumësyresh të pahulumtuara më parë në historiografinë shqiptare. Suksesi i misionarëve protestantë qe edhe se hapën pika/depo magazinimi – fillimisht në Shkodër

e në Janinë – që të shërbën në trojet veriore edhe ato jugore. Arsyja e këtyre nismave të mëdha edhe për kombet e vogla që tepër e thjeshtë e praktike, si dhe e lidhur ngushtësisht me objektivin e tyre kryesor: *lexueshmëria* e shkrimit të shenjtë. Nëse tashmë Fjala e Zotit mund të lexohej tashmë edhe nga shqiptarët, si do të mund ta lexonin ata, kur shkalla e analfabetizmit që tepër e lartë dhe shqipja ishte ende një gjuhë e palëruar; kjo do të përbënte edhe arsyen pse ata u interesuan edhe për çështjet arsimore të shqiptarëve. Papërgatitja për lexmin e botimeve do t'i conte përfaqësuesit e Shoqërisë Biblike në zgjidhje të vështira e komplekse, siç ishin: zgjidhja e një sistemi sa më të thjeshtë drejtshkrimi (ai i Lepsiusit për shqipen), në mënyrë që të përdorej sa më lehtë nga një komb analfabet; zgjedhja e një alternative për alfabetin, duke qenë se shqipja kishte edhe tinguj të veçantë, kështu, me disa ndryshime për tingujt e veçantë ata përzgjodhën germat greke për botimet në toskërisht dhe germat latine për botimet në gegërisht; kultura editoriale dhe kujdesi në proceset e botimit; pasqyrimi i alfabetit të përdorur, si ndihmesë për shqiptimin e tingujve; reklamimet në pasballinë – kur teksti batohej në toskërisht reklamonte edhe tekstin gjegjës në gegërisht dhe e anasjella, çka mund të ndihmonte në unitetin kombëtar dhe lexmin për çdo shqiptar, pa dallime krahinore. Kontribut të jashtëzakonshëm për shqipen e shkruar dha dyshja Alexandre Thomson dhe Konstantin Kristoforidhi. Për Alexander Thomson, shqipja e shkruar në fillim të shek. XIX qe një *tokë e panjohur* (*terra incognita*), e për të, puna e BFBS-së pa mësuesit e alfabetit do të ishte bërë përgjysmë, prandaj ai e pa të udhës që bashkë me shkrimet e shenjta të botosheshin e të shpërndaheshin njëkohësisht dhe masivisht edhe abetaret e K. Kristoforidhit (1866, gegërisht dhe 1867, toskërisht). Për këtë, D. Hosaflook sjell në vëmendje të hulumtimit të tij veprimtarinë e pashlyeshme në historinë e zhvillimit të librit shqip të këtyre dy figurave, të cilët përmes angazhimit dhe projekteve të tyre nxitën ndër shqiptarët ndjenjat kombëtare, letrare, kulturore, fetare dhe arsimore, jo vetëm në qytetet kryesore të Shqipërisë, por edhe në zonat më të thella të saj, pavarësisht vështirësive infrastrukturore po dhe sulmeve të kaçakëve, me të cilat u ndeshën plot misionarë. Sipas prof. Xhevati Llosit, Konstantin Kristoforidhi e kishte përdorur Shoqërinë Biblike si një shtëpi botuese për qëllimet e tij kombëtare, sepse



për të qe një zgjidhje e përshtatshme për depërtimin e librave shqip. Filozofia e misionarëve, e cila përshkruhet gjërisht në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet në Vendet e Huaja (*American Board of Commissioners for Foreign Missions*, ABCFM), konsistonte në dy qëllime kryesore: *ungjillëzimin* dhe *arsimin*. Prof. Xh. Lloshi thekson në parathënie, se: "...synimet dhe veprimtaritë konkrete të Lëvizjes Protestante janë përputhur me synimet kryesore dhe me veprimitarinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke e bërë këtë libër edhe një shpalosje të re të një anë të rëndësishme të Rilindjes Shqiptare". Po ashtu, të angazhuar prej Shoqërisë Biblike qenë edhe anëtarët e familjes Qiriazi, të cilët nuk ishin vetëm veprimitarë aktivë në shërbim të çështjet kombëtare dhe të shkollave shqipe, por, e mbi të gjitha, ata ishin përgatitur për "të përhapurit" e Ungjillit edhe të shkronjavet shqipe ndë Shqipëri, me ç'do farë mënyre të drejtë" (Kanonizma e Vëllazërisë Ungjillorëvet ndë Korçë). Përpos çështjes kombëtare, që gëlonë në periudhën kur jetuan dhe vepruan Qiriazët, ata paralelisht e pandërprerë i shërbjen ndricimit *arsimor* dhe ndricimit *shpirtëror* të kabit tonë. Në librin *Lëvizja Protestante te shqiptarët*, ndër të tjera, flitet edhe për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës së Shoqërisë Biblike, për të botuar Shkrimin e Shenjtë në gjuhën shqipe dhe për angazhimin në këtë punë të shqiptarëve të aftë e të arsimuar jashtë vendit. Ata e panë të nevojshme të harmonizonin disa procese zinxhirore, si: botimet në gjuhën shqipe, shpëndarjen masive të tyre, hartimin e abetareve, gra-

matikave e fjalarëve, themelin e shkollave në gjuhën amë dhe emancipimin e femrës shqiptare – të gjitha këto, për të arritur në iniciativën fillestare, që ishte *përhapja e Fjalës së Perëndisë* në gjuhën të cilën *populli e kuptonte* – e kjo ishte gjuhja amtare. Me këto përpjekje të vijueshme e me intensitet të lartë nga viti në vit, libri shqip po përhapej me shpejtësi në mbarë trevat shqipfolëse, duke krijuar kështu një këndvështrim bindës mbi vetë shqiptarët, çka shërbue dhe i ndihmoi ata edhe në përforçimin e ndjenjës kombëtare. Botimet në gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike u shtypën në

tirazh të madh dhe u shpërndanë, përmes rrjetit të *librashitësve shëtitës*, deri në skajet më të largëta të trojeve shqiptare, duke bërë që të rezultonte në strategjinë më të frytshme të kohës. Edhe pse libri i D. Hosaflook fokusohet më së tepërti në trajtimin e lëvizjes protestante të shqiptarët dhe te çështja e shkrimit të shenjtë në gjuhën shqipe, këto nuk mbeten trajtesat e vetme, përkundrazi, në të shqyrtohen gjërisht e deri në shterim shumë çështje lidhur me Shqipërinë e shek. XIX dhe fillimishek. XX, duke rrokur në tërësi mjaft faktorë. Përtej vlerave profesionale në hartimin e

librave të tillë, do të vlerësoja më së pari vlerat gjuhësore të autorit, në njojjen e në zotërimin e shqipes standarde – vlera të cilat janë tepër të lakuara për vetë ne shqiptarët, kur bëhet fjalë edhe përdorime të veçanta të trajtave të shqipes. Përgëzime ISSHP-së (Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante) për këto botime të vyera që po shtohen radhazi në letrat shqipe; rëndësia e të cilave vërehet përmes pasqyrimit shkencor dhe drithësimit të një sërë të dhënash të historisë sonë, por edhe për vendin që zënë në historiografinë shqiptare.



TË DHËNA MBI AUTORIN


David Hosaflook u lind më 1970, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Menjëherë sapo kreu studimet universitare në vitin 1992, për teologji, ai erdhë Shqipërinë për një mision humanitar në ndihmë të jetimëve. Plani i tij ishte për të qëndruar në Shqipëri vetëm dy muaj dhe të vazhdonte studime pasuniversitare, por, si shumë të huaj, u rrëmbye nga dashuria për popullin shqiptar. Gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri ka punuar në disa qytete: Tiranë, Shkodër, Tropojë, dhe sot vijon në vitin e tij të 28-të në Ballkan. Hosaflook-u është njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe dhe më 2012-n, në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë botoi për herë të parë në anglisht *Rethimi i Shkodrës*, i autorit shqiptar Marin Barleti, duke bashkëpunuar me historianë të huaj për ta pajisur librin me shënimë historike. Më 2017, D. Hosaflook përfundoi studimet e doktoraturës në Histori, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës. Pikërisht libri *Protestante te shqiptarët: 1816-1908* është varianti i botuar, me

ndryshime të vogla, i disertacionit të tij, i cili u botua më 2019 në Shkup, nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, me mbështetjen e Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhëniet Bashkësive të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në Prishtinë, nga shtëpia botuese "Tenda". Gjatë kohës së hulumtimeve për Lëvizjen Protestante, Hosaflook-u themeloi në Tiranë, më 2016, Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante. Aktualisht Dr. Hosaflook është drejtori ekzekutiv i tij, dhe ka ndërtuar një bibliotekë dhe arkiva burimesh me mijëra dokumente me interes për historinë e shqiptarëve po dhe të popujve të rajonit, duke ndriçuar e duke theksuar në veçanti shembujt e bashkëjetesës dhe harmonisë mes popujve të Ballkanit.

Disa nga titujt e botuar prej David Hosaflook mund të veçnim: *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816-1908* (2019), albumin *Libri shqip dhe veprimtaria protestante: 200 vjet rrugëtim kulturor/ The Albanian Book and Protestant enterprise: a 200-year cultural journey* (2017), *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the British and Foreign Bible Society* (2017), *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the American Board of Commissioners for Foreign Missions/ Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet në Vendet e Huaja* (2017) etj.

Dr. Hosaflook ka organizuar disa konferenca shkencore me karakter rajonal ballkanik, përfshirë edhe Konferencën Ballkanike me rastin e 500 vjetorit të Reformacionit Protestant në Shkup. Ai është anëtar i disa institucioneve kulturore e shkencore në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut e Amerikë; organizues i ekspositave në bashkëpunim me biblioteka kombëtare; kumtues dhe pjesëmarrës i përplot konferencave shkencore e kulturore; pjesëmarrës nëpër disa debate e prezantime publike në të gjitha hapësirat mediatike shqiptare në Ballkan, merret me përkthime librash, dhe në cilësinë e editorit dhe deri më tanë ka përgatitur për botim mbi njëzet tituj veprash. Më së fundmi, ai është nderuar me çmimin "Unsung hero in enabling integration of the Albanian community in the UK" (2020), në Londër, nga Shpresa Programme dhe me çmimin shtetëror të Maqedonisë së Veriut "22 Nëntori - Kongresi i Manastirit, Dita e Alfabetit", për kontributin e dhënë në hulumtimin dhe studimin e Kongresit të Manastirit, e në veçanti për zbardhjen e fatit të familjes Qiriazi.

David Hosaflook është lektor për historinë e krishterimit e të qytetërimit europian dhe për filozofinë e religionit. Ai vazhdon veprimitin e tij të predikimit të Ungjillit në bashkësi ungjillore dhe ftohet shpesh nëpër konferanca ndërkombëtare, që të jetë i pranishëm me kumtesat e tij./exlibris.al



FHK-ja, thirrje hendbollistëve në diasporë: Kosova po ju pret

Federata e Hendbollit e Kosovës ka kërkuar nga talentët në diasporë ta pranojnë ftesën për ta përfaqësuar Kosovën. FHK-ja e sheh suksesin e Përfaqësueses A në gjeneratat e reja



"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Federata e Hendbollit e Kosovës mbetet e përkushtuar për ngritje të nivelit të gjithëmbashëm. Prej prioriteteve të FHK-së është organizimi sa më i mirë dhe ngritja e vazhdueshme e cilësisë në ekipet përfaqësuese të grupmoshave të reja, pasi ato janë bazë për Përfaqësuesen A sa i takon të ardhshmes së afërt. Si te meshkujt ashtu edhe te femrat në Përfaqësuesen A kanë avancuar shumë e shumë hendbollistë e hendbolliste që më parë kanë luajtur për grupmosha, ndërsa FHK-ja është e vendosur që këtë trend ta avancojmë.

"Hendbollistët dhe hendbollistet e klubeve të vendit mbeten bazë e fuqishme për ekipet përfaqësuese, por ne shumë llogarisim edhe në

hendbollistë dhe hendbolliste të reja që hendbollin e mësojnë dhe e luajnë në vende të ndryshme evropiane. Kombinimi i lojtarëve që hendbollin e mësojnë dhe e luajnë në Kosovë dhe i atyre që e mësojnë dhe e luajnë në Evropë po del të jetë shumë i suksesshëm. Derisa për hendbollistët në vend kemi më shumë informata dhe mund të përcillen vazhdimesh, kjo është më pak e mundshme për hendbollistët në vendet evropiane. Për këtë ne u bëjmë thirrje të gjithë hendbollistëve të rinj që ushtrojnë e luajnë në nivel serioz në vende evropiane që të kontaktojnë FHK-në për të qenë në dispozicion përgjedhje eventuale në ekipet përfaqësuese të grupmoshave të reja", thuhet në njoftimin e FHK-së. Federata e Hendbollit i ka ftuar prindërit e lojtarëve që të përfshihen në këtë proces, kurse

Kosova ka nevojë për lojtarë cilësorë dhe të talentuar, ndërsa lojtarët e rinj dhe prindërit e tyre e kanë mundësinë që të jalin kontribut në aspektin sportiv për vendin e tyre e, po ashtu, që të bëjnë hap të rëndësishëm në karrierë duke luajtur në një përfaqësuese që po ngritet vazhdimesh. "Përgjedhjen në fund e bëjnë selektorët dhe shtabet teknike, por ftesa është e hapur për t'u vënë në dispozicion të Kosovës. Kjo mund të bëhet përmes e-mailit: office@kosovahandball.info, apo përmes faqeve zyrtare të FHK-së në rrjetet sociale. Të kujtojmë që ekipet kombëtare U18 e U20 në janar të vitit 2021 kanë kampionatet evropiane e më pas verën e ardhshme edhe kombëtaret e reja të hendbollisteve. FHK-ja dhe ekipet përfaqësuese të saj i mirëpresin të gjithë", thuhet në njoftimin e FHK-së.

Neziri: Ndjenjë e veçantë të luash për Kosovën

Prishtinë, 8 qershor - Trajnerët dhe lojtarët e Kosovës vazhdojnë të jalin mesazhe që të jeni sa më shumë aktivë në këtë kohë pandemie, edhe pse janë pezulluar aktivitetet sportive për shkak të pandemisë Covid-19. Për basketbollistët është e rëndësishme që të mbahet forma fizike dhe të jenë të përgatitur për edicionin e ri. Leon Neziri është një basketbollist i talentuar që luan në Angli. Ai ka treguar si po stërvitet tani, çfarë ndjenjë është të luash për

Kosovën dhe mesazhi për lojtarët. "Për shkak të pandemisë, formën e trupit përpinqem ta mbaj në kushte shtëpiake. Të luash për Kombëtaren e Kosovës është një ndjenjë emocionuese sepse përfaqëson shtetin dhe jep maksimumin. Mesazhi im për lojtarët është që të jenë aktivë dhe pozitivë deri në fund të kësaj situate. Qëndroni të sigurt", ka thënë Neziri me anë të një video mesazhi përfaqen zyrtare të FBK-së.

SHKURT

Lazio arrin marrëveshje me Muriqin

Sulmuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, është shumë afër transferimit në Itali. Mediat turke raportojnë se sulmuesi nga Kosova ka arritur marrëveshje me skuadrën e Lazio, kurse kjo marrëveshje pritet të bëhet zyrtare në ditët e ardhshme. Interesim për sulmuesin e Fenerbahçes kanë shfaqur Tottenham Hotspur, Burnley, West Bromwich Albion, Stade Rennes dhe Napoli. Shuma që do t'i paguajë Lazio skuadris turke për sulmuesin shtatlartë është 20 milionë euro.

Kabashi, Munishi: Edhe 20 vjet je trajner i Ballkanit

Ballkani, pas barazimit me Drenicën (0-0), e ka humbur pozitën e parë në renditjen tabloore të Superligës. Pavarësisht këtij fakti, presidenti Arsim Kabashi ka konfirmuar se Ismet Munishi do ta vazhdojë punën e trajnerit edhe nëse skuadra e Ballkanit nuk e fiton titullin. "Baba i trajnerëve në shqiptari, edhe 20 vjet ka kontratë me Ballkanin, edhe nëse kurri nuk bëhem kampionë. Krenarë dhe falënderues për gjithçka që po jep për klubin e qytetit", ka shkruar Kabashi në profilin e vet në "Facebook".

Korenica: Prishtina synon titullin dhe Kupën

Meriton Korenica ka qenë lojtari kryesor në fitoren e Prishtinës me rezultat 8-1 ndaj Ferizajt pasi ka shënuar tri gola në këtë ndeshje. Me tre golat e shënuar në fundjavë, Korenica ka shkuar në kuotën e shtatë golave në kampionat këtë edicion, derisa numëron edhe disa asistime.

Ish-anëtar i Shkëndijës së Tetovës dhe Lirisë së Prizrenit ka thënë se synon që me Prishtinën t'i fitojë dy trofetë këtë edicion. "Fitore shumë e rëndësishme si dhe ecuria jonë. Shpresoj kështu të vazhdojmë me lojëra të mira dhe çdo ndeshje t'i qasemi maksimalisht. Kemi një qëllim përrpara, kupë e titull dhe duke parë që ekipi po shkon shumë mirë, besoj shumë se në fund të gjithë së bashku, duke i ndihmuar njëri-tjetrit, do t'ia dalim", ka thënë Korenica. "Ky rezultat i thellë tregon më së miri punën që jemi duke e bërë. Jam jaftëzakonisht i kënaqur me gjithçka", ka dekluar Korenica.



Votimi i FFK-së ia pamundësoi Lirisë kthimin në Superligë

PRIZREN, 8 QERSHOR - Kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, në rrjetet sociale ka postuar letrën e pranuar nga Klubi KF Liria, nëpërmjet së cilës klubi prizrenas ka njoftuar se si i është mohuar mundësia e ngjitet në Superligë nga Federata e Futbollit të Kosovës.

FFK-ja ka vendosur të mos vazhdohen garat në rangjet e tjera, me përjashtim të Superligës, për shkak të pandemisë COVID-19, ndërsa dy klubet e para në rangun e dytë në momentin e ndërprerjes janë ngjitur automatikisht në elitë. Në këto pozita kanë qenë Besa dhe Arbëria, ndërsa Liria

ishte një vend më poshtë. Ishte pesë pikë prapa Arbërisë. "Për shkak të tendencës për politizim të futbollit, e cila ka shkaktuar shumë dëme për sportin në të kaluarën, dua të ndaj me opinionin publik letrën e KF 'Liria' lidhur me padrejtësitë që i janë bërë klubit nga ana e Federatës së

Futbollit të Kosovës. Liria ka qenë në rrugë të drejtë të kthehet në Superligë, por një gjë e tillë e ka pamundësuar votimi në FFK. Me shpresë që sporti të ngadhënjejë ndaj politikës. Duhet të kemi politikë me sportivitet, e jo politikë në sport", ka shkruar Haskuka në "Facebook".



Drejtuesit e FBK-së vëzhgojnë punimet në palestrën e Istogut

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, së bashku me drejtorin e përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova dhe anëtarin e Bordit të FBK-së, Kastriot Blakajm kanë vizituar Komunën e Istogut, ku janë pritur nga kryetari i kësaj komune, Haki Rugova dhe drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Drin Sadikaj. Në këtë takim është diskutuar për të ardhmen e basketbollit në Komunën e Istogut.

Kryetari i FBK-së i ka falenderuar për mikpritjen dhe është shprehur se Komuna e Istogut ka përparrësinë në basketboll, duke qenë se popullsia e Istogut për nga gjatësia është e treta në Kosovë. Gjithashtu, Istogu është një vatër e basketbollit. "Fetahu ka vlerësuar punën e deritanishme nga KB Istogu me të gjitha kategoritë dhe ka shprehur gatishmérinë për ndihmë, kurse edhe Rugova është zotuar se do ta ndihmojë basketbollin në



këtë komunë. Bashkëfolësit u pajtuan për rëndësinë e Klubit të Femrave në Komunën e Istogut. Kryetari i Istogut, si një ish-basketballist, ka shprehur dëshirën që ta ndihmojë Klubin e Istogut dhe në vazhdimësi e ka bërë një gjë të tillë", thuhet në njoftimin e FBK-së. Granit Rugova, drejtor i

Përfaqësueseve të Kosovës në Basketboll, në fund të takimit i dhuroi kryetarit të Istogut fanellën e Kosovës. Gjatë kësaj vizite kërët e FBK-së kanë vëzhguar edhe punimet në palestrën në Istog, duke shpresuar se do të jetë sa më shpejt e gatshme për gara dhe të bëhet inaugurimi i saj.

Duranti refuzon të luajë në këtë sezon

ORLANDO, 8 QERSHOR - Sezoni 2019-2020 i NBA-së do të rinisë më 31 korrik në Orlando, Florida, ku do të luhën disa nga ndeshjet e mbetur të sezonit të rregullt dhe më pas "play-off"-i. Në këtë fazë nuk do të marrë pjesë një nga yjet e NBA-së, Kevin Durant që, në fakt, në sezonin e parë me Brooklyn Nets nuk ka luajtur asnjë ndeshje. Ai është dëmtuar një vit më parë dhe kur mendohet se mund të aktivizohej në pjesën e mbetur të sezonit, ka qenë vetë lojtari që ka vendosur të kundërtën. "Sezoni im ka përfunduar. Nuk kam asnjë dëshirë për të luajtur kështu. Ky vendim është marrë që verën e kaluar me klubin, që këtë vit nuk do të luaja. Zoti e di se me sa dëshirë e pres rikthimin në fushë, por është më mirë të pres edhe pak", ka thënë Durant. "Nuk jam ende gati për të luajtur me



këtë intensitet që kërkon kjo periudhë, me kaq shumë ndeshje. Në të shkuarën disa herë kam luajtur para kohe dhe jam dëmtuar sërisht. Nuk dua të rrezikoj. Pata një dëmtim të rëndë, që kërkon kohë dhe dua të jem në 100 % të formës kur të rikthehem", ka thënë Durant.

SHKURT

KOK-u proceson pagesat për Bursat Olimpike dhe Shpresat Olimpike

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka filluar procesimin e pagesave për bursistët olimpike "Tokio 2020" dhe Shpresat Olimpike "Tokio 2020". Pavarësisht prej vështirësive ekonomike dhe financiare të krijuara pas pandemisë Covid-19, KOK ka procesuar pagesat në vlerë 28 300 euro për muajt janar, shkurt, mars dhe prill 2020. 17 sportistë elitarë do të marrin 20 300 euro nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe 4 000 euro nga KOK-u. Ndërkohë, për 10 Shpresat Olimpike 2020 KOK ka ndarë 4 000 euro për katër muajt e parë të këtij viti. Javë më parë janë procesuar edhe pagesat në vlerë 10 634 euro për tre bursistët olimpike "Pekini 2022". Në total, KOK-u ndanë 31 bursa për sportistët elitarë dhe Shpresat Olimpike, përfshirë këtu edhe mundësin Egzon Shala, i cili ka fituar normën olimpike "Tokio 2020" dhe i cili do të hyjë në listën e pagesave prej 1 maj 2020.

Messi është gati për rifillimin e La Ligas

Trajneri i Barcelonës, Quique Setien, ka siguruar të gjithë tifozët se Lionel Messi do të jetë gati për rifillimin e kampionatit ndaj Mallorcas. Madje jo vetëm argentinasi, por edhe Luis Suarezi do të jetë i gatshëm. "Ndonjë lojtar nuk është stërvitësi masë paraprake për shkak të ndonjë kontraktimi të lehtë, por Messi është mirë dhe nuk do të ketë asnjë problem. Kalendarë do të jetë shumë i ngjeshur, por unë gjithmonë preferoj ta kem Messin në fushë. Atëherë do të shohim se çfarë do të ndodhë. Suarezi është në gjendje shumë të mirë, ka marrë ngarkesën e duhur në stërvitje. Ai është shumë më mirë sesa që e prisnim, por gjithmonë ka paqartësi pas një kohe kaq të gjatë pa luajtur", ka thënë Setien.

Leno: Bundesliga është e mërzitshme

Bernd Leno ka luajtur me Stuttgartin dhe Bayer Leverkusenin përpara se të transferohet tek Arsenalit në verën e vitit 2018. Portieri gjerman, i cili numëron gjashtë ndeshje të zhvilluara me kombëtaren, nuk sheh asgjë interesante te Bundesliga. Në një prononcim për SWR Fussball, 28-vjeçari flet hapur rrëth dominimit të Bayern Munchenit, që kryeson me 7 pikë nga vendi i dytë dhe është shumë afër fitimit të titullit të radhës. "Bayern Muncheni ka fituar titullin kampion, si gjithmonë, si çdo vit. Kampionati gjerman është i mërzitshëm dhe i trishtueshëm. Gjithmonë ka shpresë se do të bëhet një garë emocionuese për titullin, por nuk shoh se do të ndodhë diçka e tillë në vitet e ardhshme. Bayerni është shumë i fortë", ka deklaruar portieri i Arsenalit.

Ducati, afër rinvimit me Dovizioso

Piloti italian i Moto GP, Dovizioso, pritet që ta vë firmën në kontratën e re me skuadrën e Ducatit. Dyshimet ishin të mëdha për të ardhmen e pilotit italian, i cili është në muajt e fundit të kontratës. Madje kishte zëra se skuadra e Ducatit po mendon për Jorge Lorenzo si zëvendësues i mundshëm i Doviziosi. Deri më tanë ka pasur edhe lëvizje të tjera në Ducati. Jack Miller do të jetë zyrtarisht me këtë skuadër, kurse Danilo Petrucci do të largohet. Sipas raportimeve të mediave italiane, pikëpyetjet e vetme për rinvimin janë të hollat dhe jo gjatësia e kontratës. Megjithatë, Dovizioso pritet që së shpejti ta gjejë pajtimin me skuadrën që ka bazën në Itali. Kujtojmë se Ducati nuk ka qenë asnjëherë më keq sesa pozita e shtatë, kur Dovizioso ka qenë në skuadër.

						Autor: GAZMEND MORINA	AFTËSIA E NLERİUT PËR TË KRIJUAR	LLOJ ZOGU KËNGËTAR		FORTESË LIMIT	ERA E MIRË	SHTET I MADH NË AZI	EPOKA ERE	BASHKËT.	OLIVER NEUVILLE	FARMACI	PËREMËR PRONOR
QE UA MBATH KËMBËVE NGA FRIKA													HATAJA AKTORI MORINA				
SËMUNDJE E RËND QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.)													ZULMË TËRHEQJE				
LLOJ GJARPRI													"RISANI" IZET FETAHAJ				
GJILANI, ARTANA						MBIEMËR CILËSOR	LETRARI CAMAJ ARIANITI (perkdh.)									EMËRIMI NË NJË POZITË	
AKTORJA CAHANI												EMËR YNI MASHKULLI NANTES					
DJALI I VAJZËS										"N" para dy "A" KÜLAÇE (shq.)					"TORINO"		
PADITËSI I SOKRATIT										DY BASHKË- TINGËLLORE "IRLANDA"					OLIVIER MARTINEZ ZANOUE		
EPOKA ERE	MANEKINIA SHQIPTARE HITAJ	PËRCAKTIM, PËRKUFIZIM	URANI, KRABONI	SHTET AFRIKAN (pashq.)	PJESËTAR I NJË FISI ILIRI	FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.)						SHTET AZIATIK (pashq.) DËSHIROJNË					
SJELLJA E NJERËZISHME							ZANOUE MJET I THJESHTË PUNE								ESTONIA, NORVEGJIA KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN		
FLETA E VOGËL, KU MJEKU SHËNON LLOJET E BARNAVE						SULM E HAPUR									ZANOUE FIGURË E RIPRODHUAR E NJË SENDI, SHËMBELL- TYRË		
AGIM TEJECI				LLOJ METALI LUTJE DREJ- TUAR ZOTIT (misl.)			KËNGËTARJA ITALIANE PAUSINI	UGANDA POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN				ANKESË SONDAZHI					
KËNGËTARJA E NJOHUR SHQIPTARE NË FOTO										ALEN NURI OSAKA			NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE FEMRAT LUFTETARE (mit. greke)				
BIMË SHUM- ËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË				BASHKËT.		KALIBËR I TYTËS SË ARMËS QE VEPRON ME GJALLERI						SKAJI, QOSHJA ISMET MALAJ			ALBANOLOGIA DURHAM		
GURRA						AMPER, ALUMIN SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË		DY ZANOUE AUSTRIA, ISLANDA				AKTORJA AMERIKANE BASINGER FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI			ZHAN EDUARDSON DISIPLINË SPORTIVE		
EPOKA ERE	ZANOUE I THAJ			BËRË ANKESË ANA VISI					LUMË NË SHQIPËRI TERËSIA E ORENDIVE						BASHKËT. KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA		
ZEMËRIM						ORGANIZATA MAFIOZE ".....KINEZE" FARISHTA							PERËNDIA				
QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI						ANTON PASHKU	KLUB FUTBOLLI ARGENTINAS "... LORENZO"	SOLISTJA BYTYQI VENDËSI				PEZMATIM I VESHTIT U PESHOVA					
ERMAL MAMAQI				LLOJ MOTOÇ- IKLETË QE PRODHOHET NË JAPONI AKTORI CRUISE (shq.)							QE S'KA TJET- ER TË NGJAS- HËM ME TË TË LUTEM					ILAÇI	
BASHKËT.			GOTË PREJ BAKRI KAMION I VOGËL			PEIZAZH I GJERË SPEECH AUSTRALIA PATHOLOGY									ANITA BITRI PËREMËR VETOR		
EPOKA ERE	ISH PRESIDEN- TI AMERIKAN XHEFEISON NË E RESHUR					SHEGË TENI ANDERSON						ENË E MADHE PËR TË MBAJ- TUR QUMËSHT TANTAL					
POTERË (sh.shq.)						MJET PËR SITJE (sh.shq.) SHKRONJA XXIV								RAST BASHKËT.			
PËREMËR PRONOR				KAMPIONI, ASI					DEGË E MJEKËSISË								



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel.+381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 21 paragrafi 21.3.6 të Statutit të KRM "Çabratı" Sh.A., Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 05.06.2020, vendosi që me datë 09.06.2020 të rishpall ketë:

KONKURS

<u>Pozita:</u>	Kryeshef Ekzekutiv
<u>I përgjigjet:</u>	Bordit të Drejtoreve
<u>Vendi:</u>	Gjakovë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtoreve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimit të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjeter e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtarë i kualifikuar i një profesiuni tjeter i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së;
- të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- njohja e gjuhëve të huaja eshtë përparësi;
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime;
- një program zhvillimor për kompaninë.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Ne pajtim me Ligjin, Kodin e Etikes, Qeverisjen Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin, duke iu nënshtruar vetëm përkufizimeve të BD ka autoritetin të lidhë kontrata për Kompaninë;
- Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Kompanisë të cilat nuk janë në përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Drejtoreve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm do të vendosen sipas direktivave dhe përgjegjësisë së Kryeshef Ekzekutiv;
- Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtoreve në përcaktimin e strategjisë së kompanisë si dhe planet e sajë strategjike afatgjate;
- I ofron Bordit të Drejtoreve kurdo që eshtë e nevojshme dhe së paku një herë në tre muaj raporte për transakzionet kryesore të ndërmarra nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punës së kompanisë;
- Ofron Bordit të Drejtoreve rregullisht së paku çdo tre muaj raportet e matjes së përformançës së kompanisë;
- Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në kompani;
- I ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informata dhe asistencën që mund të kerkohet;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme.

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtoreve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacionit duhet bashkangitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografija);
- Letërnjoftimi - kopje;
- Letër motivimi;
- Deklarata nën betim;
- Diplomën e kualifikimit (minimum universitare) - kopje;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më te vjetër se 3 muaj - origjinale;
- Programi zhvillimor për kompaninë.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zanfë myllur me shënim: "Për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Çabratı" Sh.A.". Afati i dorëzimit eshtë nga data 09.06.2020 deri me datë 23.06.2020 në ora 16.00.

Kërkesat e dorëzuar pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen nga Bordi i Drejtoreve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel.+381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

Na osnovu člana 21. Zakona br 03 / L-087 o Javnim Preduzećima (objavljen u Službenom Glasniku od 15.06.2008), izmenjen i dopunjeno Zakonom 04 / L-111 (objavljeno u Službenom Glasniku od 30.05.2012), člana 21, stav 21.3.6 Statuta RKO "Çabratı" AD , Upravni Odbor na sednici održanoj dana 05.06.2020, je odlučio da 09.06.2020 ponovo raspisuje:

KONKURS

<u>Pozicija:</u>	Glavni izvršni direktor
<u>Odgovara:</u>	Upravnom Odboru
<u>Mesto:</u>	Dakovica

Uslovi i potrebne kvalifikacije :

Upravni Odbor želi da se osigura da svi potencijalni kandidati su osobe sa priznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, kao i da zadovoljavaju kriterijume o nezavisnosti prema članu 17.2 tacke (d), (f), (j), (k) i (l) Člana 17.3 tačka (a) i (b) obaveze izjave pod zakletvom prema članu 17.5 Zakona o Javnim Preduzećima i da imaju odgovarajući stručnu spremu i obrazovanje za poziciju koja je u pitanju.

Pored ovih opštih uslova kandidati moraju ispunjavati i ove sledeće posebne uslove:

- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva na visokom nivou menadžmenta u oblasti poslovog menadžmenta, korporativnih finansija, finansija, upravljanje rezora, banke, konsultantske usluge u poslovanju, industriji ili bilo koje druge oblasti nauke koji se bavi aktivnošću PJ- u trajanju od najmanje pet godina, da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani pripadnik bilo koje druge profesije koja je usko povezana sa poslovnim aktivnostima PJ;
- da ima visok moralni i profesionalni integritet;
- da ima dokazanu sposobnost za upravljanje;
- poznavanje stranih jezika je prednost;
- da nije osuđivan, ili pod istragom;
- jedan program razvoja za kompaniju.

Glavne obaveze i odgovornosti:

- U skladu sa Zakonom, Etičkog kodeksa, Korporativnog upravljanja, Javnih Preduzeća i Statuta, podležući samo definicijama UO ima ovlašćenje da sklapa ugovore za preduzeća;
- Sva pitanja u vezi sa poslovanjem Kompanije koje nisu u nadležnosti Skupštine Akcionara, Upravnog Odbora, Komisije za Reviziju ili službenika za Internu Reviziju će biti stavljeni pod direktivama i odgovornosti glavnog izvršnog službenika ;
- Savetuje i pomaže Upravni Odbor u određivanju strategije kompanije i njenih dugoročnih strateških planova;
- Pruža Upravnom Odboru po potrebi, a najmanje jednom u tri meseca izveštaj o velikim transakcijama od strane kompanije i glavne odluke donete od strane rukovodstva u vezi sa vođenjem poslovanja i kompanije radova ;
- Pruža Upravnom Odboru redovno barem svakih tri meseca izveštaj za merenje performansi kompanije;
- Uspostavlja i pregleduje organizacionu strukturu kompanije, kao i interkonekciji moći između lidera i zaposlenih u kompaniji;
- Pruža Komisiji za reviziju sve informacije i pomoći koja može biti potrebna;
- Učestvuje u svim opštим sastancima.

Plata: U skladu sa politikom odobrene naknade od strane Upravnog odbora.

Procedura apliciranja:

Aplikaciji moraju biti priložena i ova dokumenta:

- CV- (Biografija);
- Lična karta - kopija;
- Motivaciono pismo;
- Izjava pod zakletvom;
- Diplomu kvalifikacije (minimum univerzitetsku) - kopiju;
- Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od 3 meseca-original;
- Program razvoja za kompaniju.

Podnošenje prijave i relevantne dokumentacije vrši se kod Sekretarijata Kompanije Društva u zatvorenoj koverti sa naznakom: "Za poziciju: Izvršni Direktor RKO "Çabratı" AD". Krajnji rok za podnošenje je datum od 09.06.2020 do 23.06.2020 u 16.00 sati

Zahtevi koji pristižu nakon zadnjeg datuma i nepotpuni zahtevi neće biti prihvaci na od strane Upravnog Odbora. Formalni intervju i procene će se vršiti nakon isteka roka za prijavu, dok PJ zadržava pravo formiranja kratke liste sa kandidatima koji apliciraju.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe te Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpallojnë :

KONKURS

Titulli i punës: Arkitekt -1 pozitë

Institucioni: Institut i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve-IKMM

Vendi: Prishtinë

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore Grada VIII

Paga: Paga Fiksë

Numri i referencës: 08/2020

I përgjigjet: Drejtorit të IKMM

Detyrat dhe përgjegjësitet: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve-IKMM, kryen detyrat dhe përgjegjësitet e mëposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjeter profesional për zbatimin e shërbimeve në fushën e Trashëgimisë Kulturore ;
2. Bashkëpunon ne mënyrë te vazhdueshme me Departamentin e Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet tjera te Trashëgimisë Kulturore, për realizimin e objektivave te Institutit te Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve-IKMM;
3. Kryen detyrat në fushën e Trashëgimisë Kulturore, me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e trashëgimisë kulturore, kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushën e arkitekturës për shkak te interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjeter në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvaja, aftësitet dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtesi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit ;
4. Shkathtesi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtesi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, në drejtimin e arkitekturës , minimum 2 vite përvjë pune profesionale.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 23.06.2020

Aplikacionet dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitura e kërkësave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazirujući se na Zakon Rada, Br. 03/L-212 i Uredbu br.05/2011, za određivanje Stepena i Plate za Stvaraocie i Izvođače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa, i Administrativno Uputstvo (MRSZ) Br.07/2017, o Regulisanju Procedura Konkursa na Javnom Sektoru Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Arhitekta -1 pozicija

Institucija: Institut Kosova za Zaštitu Monumenata-IKZM

Mesto : Priština

Funkcionalna kategorija: Stvaraocie i Izvođače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa Grada VIII

Plata: Fiksna Plata

Broj referencije: 08/2020

Nadležnik: Direktor IKZM

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora Instituta Kosova za Zaštitu Monumenata-IKZM , izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Razija i postiže saglasnost o planovima rada I rokovima sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom, za sprovođenje usluga iz oblasti Kulturne Baštine;
2. U kontinuitetu sarađuje sa Departmanom Kulturne Baštine i ostalim institucijama Kulturne Baštine, za realizovanje objektiva Instituta Kosova za Zaštitu Monumenata-IKZM ;
3. Izvršava zadatke iz oblasti kulturne baštine, sa jednim razumnim stepenom samostalnosti, pod nadzorom i uputstvima, s vremena na vreme;
4. Vrši istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju preporuka za razmatranje, sa najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama rada iz oblasti kulturne baštine, kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar i van institucije za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti arhitekture, iz razlogazajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progresa u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične profesionalne oblasti, koji se mogu zatevati, na razložan način, s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko i specializovano znanje iz specifične profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Znanje zakona i sprovodljivih pravilnika;
3. Sposobnost u komuniciranju, planiranju i eventualnoj koordinaciji kadrovskog osoblja;
4. Istraživačka, analitička i sposobnost za procenjivanje i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru za aplikacije programa (Word,Excel,Power Point,Access);
6. Univerzitetska diploma pravac arhitekture, minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva;
7. Poznavanje Engleskog Jezika je prednost.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeno vreme. Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljuvanja.

Zadnji datum za apliciranje je: 23.06.2020

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markom, na zadnji dan objave, smatraće se važećim.

Podnošenje aplikacije: Aplikacije se uzimaju sa web stranice MKOS-a i predaju se u kacelariji br. 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte brojeve tel. 038 211 921 dhe 038 211 449, ili web-stranicu <http://www.mkrs-ks.org/>.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "IFE KOSOVA INS SAN VE TIC LTD STI", Sh.P.K, me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811277955 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "IFE KOSOVA INS SAN VE TIC LTD STI", d.o.o., u Prishtini, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811277955 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "IFE KOSOVA INS SAN VE TIC LTD STI", L.L.C, in Pristina, has taken the decision to quit its business with NUI: 811277955, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

"Epoka e re"

Prishtinë, 09.06.2020

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

P R I S H T I N Ë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpjete

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lëshoj banes me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m², e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.
- Faruk Kadriu shpallë të pavlefshëm dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" në Skenderaj.
- Jap banesë me qira afër 60 m², katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira përfatës tjetër. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet përfatës qift ose përfatës dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjnë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira përfatës apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër detyrë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër detyrë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Përfatës info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Përfatës info 044/332-640.

ROYAL CROWN
RC cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100 % mish puk

cilësi e garantuar

pa konservues